

Ahmeti: Kam informacione që ka iniciativa për të paditur Ushtrinë Çlirimtare Kombëtare në Hagë | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ALBULENA HAXHIU TAKOHET ME PËRFAQËSUESIT E PARTIVE POLITIKE PARLAMENTARE

REGJISTRIMI I DEPUTETËVE NIS TË HËNËN

| FAQE 4-5



Ushtruesja e detyrës së presidentes, Albulena Haxhiu, ka konfirmuar se regjistrimi i deputetëve të legjislaturës së re do të nisë të hënën, më 3 gusht, ndërsa seanca

konstituive e Kuvendit do të mbahet më 6 gusht. Pas takimit me përfaqësuesit e partive parlamentare, PDK-ja ka konfirmuar se do të mbetet në opozitë dhe nuk

do të bashkëqeverisë me LV-në, ndërsa LDK-ja dhe AAK-ja kanë shpalosur qëndrimet e tyre për vazhdimin e dialogut dhe konstituimin e institucioneve të reja

ABDIXHIKU I SHPËTON SHKARKIMIT, SHPREHET I HAPUR PËR VAZHDIMIN E BISEDIMEVE ME LV-në | F. 2



GUCATI DHE SYLA TAKOJNË ZYRTARET E AMBASADËS AMERIKANE, NË FOKUS PREOKUPIMET E VETERANËVE TË UÇK-së | F. 3



AKTUALE



BASHKËPUNIMI KOSOVË-SHBA, "ALBANIANS FOR AMERICA" KËRKON RIFILLIMIN E DIALOGUT STRATEGJIK | F. 6

EMISARJA BRITANIKE: GJETJET E IKKL-SË JANË KYÇË PËR ZBARDHJEN E KRIMEVE TË LUFTËS NË KOSOVË | F. 3

NIS GJYKIMI NË MUNGESË KUNDËR 21 TË AKUZUARVE PËR MASAKRËN E REÇAKUT | F. 7

EKONOMI



KOSOVA REGJISTRON MË PAK BIZNESE TË REJA, RËNIE MBI 5 PËR QIND BRENDË NJË VITI | F. 8

MINTI: ARBK-JA PUBLIKON VETËM TË DHËNAT QË LIGJI I PËRCAKTON SI PUBLIKE | F. 8

SPORT



BALLKANI, MALISHEVA DHE DUKAGJINI MBYLLIN RRUGËTIMIN NË UEFA CONFERENCE LEAGUE | F. 11

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 870
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Zelensky: Rreth 50 mijë ushtarë ukrainas janë vrarë që nga fillimi i luftës

KIEV, 31 KORRIK - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, ka deklaruar se rreth 50 mijë ushtarë ukrainas janë vrarë që nga fillimi i luftës me Rusinë, ndërsa rreth 400 mijë të tjerë janë plagosur. Sipas tij, një numër i konsiderueshëm i ushtarëve ukrainas vazhdojnë të jenë të

zhdukur, ndërsa betejat e ashpra në front kanë shkaktuar humbje të mëdha njerëzore për të dyja palët. Duke folur për humbjet ruse, presidenti ukrainas ka thënë se numri i përgjithshëm i viktimave dhe të plagosurve në radhët e ushtrisë ruse ka arritur në rreth 1.6 milion

persona, prej të cilëve afërsisht 700 mijë janë vrarë. Zelensky nuk ka publikuar detaje lidhur me mënyrën e përlogaritjes së këtyre shifrave. Të dhënat për humbjet ushtarake në luftën Rusi-Ukrainë janë të vështira për t'u verifikuar në mënyrë të

pavarur, pasi të dyja palët publikojnë shpesh shifra të ndryshme për humbjet e kundërshtarit. Lufta në Ukrainë, e nisur pas pushtimit rus në shkurt të vitit 2022, vazhdon të jetë një nga konfliktet më të mëdha ushtarake në Evropë që nga Lufta e Dytë Botërore.



TRUMPI: ARRIHET MARRËVESHJA, HAMASI DO TË ÇARMATOSSET

UASHINGTON, 31 KORRIK - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Donald Trump, ka thënë se bisedimet e zhvilluara të enjten në Kajro mes ndërmjetësve dhe udhëheqësve të Hamasit kanë çuar në arritjen e një marrëveshjeje për çarmatimin gradual të grupit militant në Gazë.

Megjithatë, një zyrtar i Hamasit e ka përshkruar marrëveshjen si një draft, ndërsa zyrtarë amerikanë kanë thënë se Izraeli nuk është i bindur se grupi militant palestinez do t'i dorëzojë armët.

Hamasi është i shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian. "Sot, Bordi i Paqes arriti një marrëveshje historike për çarmatimin e plotë të Hamasit dhe të të gjitha grupeve të tjera të armatosura në Gazë", ka shkruar Trump në një postim në rrjetet sociale, duke shtuar se çarmatimi do të bëhet me faza.

"Ky është një hap i madh drejt një paqeje dhe sigurie të qëndrueshme", ka nënvizuar Trump.

Trumpi ka thënë se marrëveshja është një hap vendimtar drejt krijimit të një qeverie të re palestineze që do ta qeverisë Gazën dhe do të bashkëpunojë ngushtë me të ashtuquajturin Bord i Paqes. "Në të njëjtën kohë, Izraeli do të ketë sigurinë që meriton, pasi Gaza nuk do të përdoret më si bazë për sulme terroriste", ka shtuar ai.

Një burim i Hamasit i ka thënë "Reuters"-it se "draft-marrëveshja" parashikon që

armët e rënda të ruhen dhe të mbeten vetëm nën kontrollin e një administrate palestineze, ndërsa ato nuk mund t'i dorëzohen Izraelit.

"Nuk do të ndërmarrim asnjë veprim lidhur me çarmatimin para se Izraeli të tërhiqet nga Rripi i Gazës", ka thënë për Al Jazeera Ghazi Hamad, anëtar i ekipit negociator të Hamasit. Një zyrtar amerikan u ka thënë gazetarëve të enjten se Izraeli është "shumë skeptik se Hamasi do të çarmatoset". "Ne jemi shumë të bindur se ata do t'i përmbahen marrëveshjes. Nëse nuk e bëjnë, padyshim që presidenti Trump do të jetë shumë, shumë i zhgënjyer", ka shtuar zyrtari amerikan.

Po ashtu, janë ngritur pikëpyetje edhe për kohëzgjatjen e procesit. Një zyrtar i Bordit të Paqes ka vlerësuar se ai mund të zgjasë nga 200 deri në 320 ditë, por një zyrtar amerikan e ka hedhur poshtë këtë afat.

Një zyrtar izraelit, i cili ka folur në kushte anonimiteti, ka thënë para njoftimit të Trumpit se Izraeli kishte refuzuar një propozim. "Izraeli kërkon çarmatimin e plotë të Hamasit, përfshirë largimin e të gjitha armëve nga Gaza dhe demilitarizimin e plotë të Rripit, si parakusht për çdo proces. Dokumenti me 15 pika nuk jep përgjigje të kënaqshme ndaj këtyre kërkesave dhe Izraeli i ka bërë të ditura mospajtimet e veta", ka thënë ai.

Udhëheqësit e Hamasit kanë zhvilluar bisedime me ndërmjetës nga Egjipti, Katari dhe Turqia për fazën e dytë të



planit të Trumpit për Gazën, ashtu siç ua kishte paraqitur Bordi i tij i Paqes.

Trumpi e ka krijuar këtë bord për ta mbikëqyrur planin që synon përfundimin e luftës së Izraelit në Gazë dhe rindërtimin e territorit të shkatërruar palestinez. Ai ka emëruar anëtarët e bordit, duke e vendosur veten në krye të tij, ndërsa vitin e kaluar ka thënë se ky organ do të mbikëqyrte qeverisjen e përkohshme të Gazës.

"Përpara nesh është një Gazë e rindërtuar, e qeverisur nga palestinezët dhe në paqe me Izraelin, me një perspektivë politike drejt një zgjidhjeje kuptimplote të konfliktit izraelito-palstinez", ka thënë në një deklaratë Nickolay Mladenov, i dërguari i Bordit të Paqes për Gazën, pas postimit të presidentit.

Zyrtarët e përfshirë në bisedime kanë ndarë pak hollësi lidhur me planet për rindërtimin e Gazës. Plani parashikon gjithashtu rritjen e ndihmës humanitare, qeverisjen nga një administratë

civile palestineze, tërheqjen e forcave izraelite nga Gaza dhe vendosjen e një force ndërkombëtare për të ndihmuar në ruajtjen e sigurisë.

Realiteti në terren në Gazë, deri tani, mbetet larg synimeve të marrëveshjes.

Hamasi ka kërkuar që Izraeli të zotohet për ndërprerjen e sulmeve ndaj Gazës dhe t'i tërheqë forcat e tij. Ende nuk është e qartë se çfarë do të ndodhë me armët e lehta ose ato personale, apo nëse qëndrimi i ri i Hamasit do të pranohet nga Izraeli ose nga Bordi i Paqes. Një diplomat i përfshirë në bisedime ka thënë se plani përfshin eliminimin e tuneleve, depove të armëve dhe objekteve për prodhimin e armëve, duke shtuar se në fund të procesit nuk do të mbetet asnjë infrastrukturë ushtarake e grupeve militante në Gaza. "Kjo nuk është në të vërtetë një marrëveshje e bazuar te besimi", ka thënë të enjten një zyrtar amerikan, duke e cilësuar atë si një "marrëveshje të bazuar në përmbytjen e kushteve".

Ndërkohë, ushtria izraelite ka vazhduar ta zgjerojë kontrollin e saj ushtarak në Gazë, ndërsa kryeministri Benjamin Netanyahu ka deklaruar se Izraeli synon ta zgjerojë zonën nën kontrollin e tij në 70 për qind të enklavës.

Ende mbetet e paqartë se sa trupa do të jenë në dispozicion për t'u vendosur në kuadër të Forcës Ndërkombëtare të Stabilizimit (FNS) dhe nëse trupat izraelite do të tërhiqen nga enklava. Kosova është në mesin e pesë shteteve të para – së bashku me Indonezinë, Marokun, Kazakistanin dhe Shqipërinë – që janë zotuar për angazhim në këtë mision, me qëllim ofrimin e sigurisë dhe mbikëqyrjen e armëpushimit në Rripin e Gazës. Në maj të këtij viti, Kosova ka dërguar një ekip ushtarak në Gazë për të bërë vlerësimin e vendit ku do të veprojë si pjesë e misionit paqeruajtës.

Zyrtarët shëndetësorë kanë thënë se sulme të ndara izraelite kanë vrarë të paktën dy fëmijë, një grua dhe tre burra në Gazë të enjten. Ushtria izraelite ka thënë se kishte goditur militantë të Hamasit në enklavë. Armëpushimi në Gazë është shkelur vazhdimisht. Sipas autoriteteve shëndetësore në Gazë dhe autoriteteve izraelite, që nga hyrja në fuqi e armëpushimit në tetor, më shumë se 1.200 palestinezë, kryesisht civilë, janë vrarë nga sulmet izraelite, ndërsa katër ushtarë izraelitë janë vrarë nga militantët. Hamasi zakonisht nuk publikon të dhëna për humbjet në radhët e veta.

Rekord historik në aviacion, mbi 153 mijë fluturime në një ditë të vetme

STOKHOLM, 31 KORRIK - 23 korriku ka hyrë në histori si dita më e ngarkuar për aviacionin komercial, pasi numri i fluturimeve të realizuara në mbarë botën arriti një rekord të ri. Sipas të dhënave të platformës së monitorimit të fluturimeve Flightradar24, gjatë kësaj dite

u regjistruan gjithsej 153 mijë e 359 fluturime komerciale, shifra më e lartë e regjistruar ndonjëherë brenda 24 orëve. Ekspertët e lidhin këtë rekord me kulmin e sezonit të pushimeve verore në hemisferën veriore, kur miliona njerëz udhëtojnë drejt destinacioneve turistike.

Për të përballuar kërkesën e madhe, kompanitë ajrore kanë shtuar numrin e fluturimeve në shumë prej linjave ndërkombëtare. Rritja e trafikut ajror ka sjellë gjithashtu ngarkesë më të madhe për aeroportet kryesore në botë, të cilat gjatë muajve të verës përballen me

numër rekord pasagjerësh dhe lëvizjesh ajrore. Ky rekord tregon rimëkëmbjen dhe zgjerimin e vazhdueshëm të industrisë së aviacionit pas viteve të vështira të shkaktuara nga pandemia, ndërsa kërkesa për udhëtime vazhdon të rritet.



AHMETI: KAM INFORMACIONE QË KA INICIATIVA PËR TË PADITUR USHTRINË ÇLIRIMTARE KOMBËTARE NË HAGË

SHKUP, 31 KORRIK - Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integritim (BDI), Ali Ahmeti, ka thënë se ka informacione për iniciativë në Gjykatën Kushtetuese të Maqedonisë së Veriut për hapjen e çështjeve që lidhen me Tribunalin e Hagës dhe paditjen e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK) për krime lufte.

Në një paraqitje në "KohaCast", Ahmeti ka thënë se rihapja e këtyre çështjeve do të rikthente plagët e vjetra dhe do të sillte dhimbje më të madhe. "Kam informacione që ka iniciativa në Gjykatën Kushtetuese për të hapur çështjet e Tribunalit të Hagës për t'u paditur Ushtria Çlirimtare Kombëtare për krime lufte. Jo që më frikëson, por të hapësh plagë të vjetra, dhimbja është më e madhe se sa kur hapet një plagë e re. Janë çështje që i kemi mbyllur më shumë se 20 vite më parë",

është shprehur Ahmeti.

Duke folur për zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit, Ahmeti ka vlerësuar se partitë shqiptare kanë pasur rolin kryesor në avancimin e saj, ndërsa ka kritikuar partitë maqedonase për mungesë angazhimi në promovimin e frymës së marrëveshjes. "Partitë shqiptare kanë punuar shumë më tepër për promovimin e Marrëveshjes së Ohrit. U kam thënë edhe partive maqedonase se nuk kanë bërë sa duhet për t'ua shpjeguar qytetarëve maqedonas rëndësinë e saj. Ekziston bindja se me zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit maqedonasit e humbasin shtetin, por kjo nuk është e vërtetë. Me Marrëveshjen e Ohrit kanë fituar edhe shqiptarët, edhe maqedonasit", ka theksuar Ahmeti.



Ai ka shtuar se sfidat më të mëdha në zbatimin e marrëveshjes kanë qenë të pranishme gjatë miratimit të Ligjit për Përdorimin e

Gjuhëve, proces që, sipas tij, është përmbyllur në vitet 2016-2017.

Sipas Ahmetit, Marrëveshja e Ohrit mbetet kompromisi

historik që ka ruajtur karakterin multietnik të shtetit dhe ka shmangur skenarin e ndarjes territoriale të Maqedonisë së Veriut.

EMISARJA BRITANIKE: GJETJET E IKKL-së JANË KYÇE PËR ZBARDHJEN E KRIMEVE TË LUFTËS NË KOSOVË

LONDËR, 31 KORRIK - E dërguara speciale e Mbretërisë së Bashkuar për Ballkanin Perëndimor, Dame Karen Pierce, i ka cilësuar gjetjet e Institutit për Krimet e Kryera Gjatë Luftës në Kosovë (IKKL) si kontribut të rëndësishëm për dokumentimin e krimeve të luftës dhe vendosjen e drejtësisë për viktimat.

Në një deklaratë të publikuar nga Ambasada britanike në Kosovë, Pierce ka thënë se dëshmitë e reja ndihmojnë në krijimin e një baze faktike për zbardhjen e fatit të më shumë se 13 mijë personave që humbën jetën ose u zhdukën gjatë luftës në Kosovë, si dhe për mijëra të tjerë që u dëbuan nga shtëpitë e tyre dhe pësuan humbje, lëndime apo trauma. "Gjetjet janë një kontribut i



rëndësishëm drejt krijimit të dëshmiave të bazuara në fakte dhe llogaridhënies për më

shumë se 13 mijë njerëz që humbën jetën ose u zhdukën gjatë konfliktit në Kosovë, si

dhe për shumë të tjerë që u dëbuan nga shtëpitë e tyre dhe pësuan humbje, lëndime apo

trauma", ka deklaruar Pierce.

Ajo i ka cilësuar ngjarjet tragjike të luftës në Kosovë si një nga periudhat më të errëta të historisë së afërt të Evropës, duke theksuar rëndësinë e përbaljes me të kaluarën dhe zbardhjes së së vërtetës. "Paqja afatgjatë kërkon që të gjitha komunitetet të angazhohen me ndershmëri ndaj së kaluarës dhe të punojnë drejt së vërtetës, pajtimit dhe mirëkuptimit të ndërsjellë", ka thënë ajo.

Pierce ka shtuar se, edhe dekada pas përfundimit të luftës dhe vuajtjeve të mëdha njerëzore, Mbretëria e Bashkuar mbetet e përkushtuar për mbështetjen e paqes dhe sigurisë së qëndrueshme në Kosovë dhe në të gjithë Ballkanin Perëndimor.

Gucati dhe Sylja takojnë zyrtaret e Ambasadës amerikane, në fokus preokupimet e veteranëve të UÇK-së

PRISHTINË, 31 KORRIK - Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Hysni Guçati, së bashku me nënkryetarin Gazmend Sylja, kanë zhvilluar një takim pune me zyrtarë të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë. Sipas njoftimit të OVL-UÇK-së, gjatë takimit janë diskutuar

temat dhe preokupimet kryesore të veteranëve. Në njoftim është theksuar edhe rëndësia e miqësisë dhe partneritetit "të pazëvendësueshëm" me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. "Sot zhvilluam një takim pune me zyrtarë të Ambasadës së ShBA-së në Kosovë, ku diskutuam për

temat dhe preokupimet kryesore të veteranëve tanë. Në këtë takim theksuam rëndësinë e jashtëzakonshme që ka miqësia e përhershme dhe partneriteti ynë me partnerin tonë më të madh e të pazëvendësueshëm, Shtetet e Bashkuara të Amerikës", është thënë në njoftimin e OVLUÇK-së.





ALBULENA HAXHIU TAKOHET ME PËRFAQËSUESIT E PARTIVE POLITIKE PARLAMENTARE

REGJISTRIMI I DEPUTETËVE NIS TË HËNËN

Ushtuesja e detyrës së presidentes, Albulena Haxhiu, ka konfirmuar se regjistrimi i deputetëve të legjislaturës së re do të nisë të hënën, më 3 gusht, ndërsa seanca konstituive e Kuvendit do të mbahet më 6 gusht. Pas takimit me përfaqësuesit e partive parlamentare, PDK-ja ka konfirmuar se do të mbetet në opozitë dhe nuk do të bashkëqeverisë me LV-në, ndërsa LDK-ja dhe AAK-ja kanë shpalosur qëndrimet e tyre për vazhdimin e dialogut dhe konstituimin e institucioneve të reja

**EPOKA
ERE****Lirim GECI**

PRISHTINË, 31 KORRIK - Kryetarja e Kuvendit të Kosovës dhe ushtuesja e detyrës së presidentes, Albulena Haxhiu, ka takuar përfaqësuesit e partive politike parlamentare, me të cilët ka diskutuar për seancën konstituive të Kuvendit, e cila do të mbahet më 6 gusht. Pas takimit, Haxhiu ka dhënë detaje lidhur me bisedimet me përfaqësuesit e partive politike, duke konfirmuar hapat e radhës për konstituimin e Kuvendit të Kosovës. Haxhiu ka bërë të ditur se, pas certifikimit të rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të 7 qershorit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 8 korrik, është caktuar seanca e parë e legjislaturës së re. “Më 8 korrik, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Kosovës certifikoi rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të parakohshme të 7 qershorit. Në bazë të kësaj, Presidenti i Republikës së Kosovës thirrri mbledhjen e parë të Kuvendit. Në përputhje me Kushtetutën, seanca konstituive do të mbahet më 6 gusht, në orën 10:00”, ka thënë Haxhiu.

Ajo ka bërë të ditur se rendi i ditës i seancës konstituive përmban katër pika: formimin e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e kuorumit dhe mandateve, shqyrtimin e

raportit të këtij komisioni, betimin e deputetëve, si dhe zgjedhjen e kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit të Kosovës. Haxhiu ka njoftuar gjithashtu se administrata e Kuvendit ka përfunduar përgatitjet për regjistrimin e deputetëve. “Regjistrimi i deputetëve do të bëhet më 3 gusht për Lëvizjen Vetëvendosje, më 4 gusht për Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe më 5 gusht për Aleancën dhe deputetët që përfaqësojnë komunitetet joshumicë në Republikën e Kosovës”, ka deklaruar Haxhiu.

PDK-ja konfirmon se mbetet në opozitë, Çitaku: Nuk do të ketë bashkëqeverisje me LV-në

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) do të vazhdojë të qëndrojë në opozitë dhe nuk do të hyjë në bashkëqeverisje me Lëvizjen Vetëvendosje (LV). Kështu ka bërë me dije sekretarja e përgjithshme e PDK-së, Vlora Çitaku, pas takimit me ushtuesen e detyrës së presidentes, Albulena Haxhiu.

Çitaku ka thënë se PDK-ja është e interesuar që institucionet e reja të konstituohen sa më shpejt, por ka përjashtuar çdo mundësi për bashkëqeverisje me LV-në. “PDK-ja ka pozicion të qartë politik: ne do të jemi në opozitë. Jemi të interesuar

që sa më parë institucionet e Kosovës të konstituohen, në mënyrë që të fillojnë të adresojnë kërkesat dhe nevojat e qytetarëve të Kosovës”, ka deklaruar Çitaku.

Ajo ka theksuar se bashkëpunimi për konstituimin e institucioneve dhe për çështje me interes për qytetarët nuk nënkupton hyrje në qeveri.

“Jemi vite larg me Lëvizjen Vetëvendosje. Kjo nuk do të thotë që nuk bashkëpunojmë për sa i përket konstituimit të institucioneve dhe interesave të qytetarëve të Republikës së Kosovës, por jo në bashkëqeverisje”, ka thënë ajo pas takimit me Haxhiun.

Duke folur për zgjedhjen e presidentit, Çitaku ka thënë se kjo çështje nuk duhet të trajtohet thjesht si një pozitë, pasi, sipas saj, zgjedhja e presidentit mund të ndikojë në vazhdimin e qeverisjes së LV-së. “Çështja e presidentit nuk është një vend pune. Zgjedhja e presidentit mundëson qeverisje kësaj qeverie”, ka thënë Çitaku.

Ajo ka përmendur edhe disa prej çështjeve ku PDK-ja dhe LV-ja kanë dallime të thella, duke përfshirë raportet me Shtetet e Bashkuara, gazsjellësin amerikan, sektorin privat, lirinë e medias, sundimin e ligjit dhe arsimin.

Sipas Çitakut, këto dallime duhet të merren parasysh në procesin e zgjedhjes së

presidentit dhe në përcaktimin e së ardhmes së institucioneve të Kosovës.

Lushaku-Sadriu: Kuvendi duhet të konstituohet pa vonesa

Deputetja e zgjedhur e LDK-së, Jehona Lushaku-Sadriu, pas takimit me kryeparlamentaren Albulena Haxhiu dhe përfaqësuesit e tjerë të partive politike, ka deklaruar se Kuvendi i Kosovës duhet të konstituohet sa më shpejt. “Ne insistojmë që seanca konstituive duhet të vijojë më 6 gusht dhe duhet të përmbyllet procesi i konstituimit të Kuvendit, me qëllim që të kemi institucione funksionale dhe të mos ketë asnjë vonesë. Ne synojmë që Kuvendi i Republikës të konstituohet në ditën e caktuar për thirrjen e seancës. Aty u miratua edhe një agjendë e cila do të prezantohet, për formimin e komisioneve, verifikimin e mandateve dhe zgjedhjen e kryetarit dhe nënkryetarëve. Kaq ishte. Ne e dhamë kontributin tonë, për aq kohë sa respektohen vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe Rregullorja e Punës së Kuvendit, dhe dëshirojmë që sa më shpejt t’ua japim institucionet shtetit tonë”, ka thënë ajo.

Lushaku-Sadriu ka bërë të ditur se, për momentin, LDK-ja nuk ka ndonjë ftesë për takim nga lideri i LV-së, Albin Kurti, duke theksuar se çdo partneritet mes partive politike duhet të ndërtohet mbi bazën e parimeve.

“Në fakt, nuk ka ndonjë ftesë tani, meqë janë përmbyllur proceset për të cilat ne e

kishim ndërprerë dialogun tonë me vendimmarrësit sa i përket këtij institucioni. Sapo të kemi një takim, do të kemi dialog dhe marrëveshje eventuale, nëse do të ketë hapësirë për një marrëveshje të tillë. Në fakt, çdo partneritet mes partive politike ndërtohet mbi bazën e parimeve bazë, sepse secila parti ka garuar me një program dhe me disa parime bazë. Ne jemi parti që qartësisht jemi të orientuar nga Perëndimi. I kemi vlerat tona bazike, të cilat dëshirojmë t’i imponojmë në çdo marrëveshje dhe në çdo krijim partneriteti. Ato janë të thena edhe gjatë fushatave tona. Dialogu mbi partneritetin dhe mbi një marrëveshje eventuale duhet të ndërtohet mbi parimet dhe pozitën, por fillimisht duhet të dakordohemi mbi parimet, qëllimet dhe objektivat e programit tonë, se si mendojmë ta orientojmë Kosovën në vitet e ardhshme. Pastaj, pozitën janë çështje tjetër”, ka thënë Lushaku-Sadriu.

Tahiri: Aleanca s’do hise në qeveri, nëse merren parasysh pikat tona do të ndihmojmë konstituimin e institucioneve

Deputeti i Aleancës, Besnik Tahiri, ka deklaruar se partia e tij nuk synon të jetë pjesë e qeverisë së ardhshme dhe as të marrë poste institucionale, por është e gatshme të ndihmojë në konstituimin e institucioneve të reja, nëse merren parasysh kërkesat e saj. Tahiri ka thënë se AAK-ja ka një qëndrim të qartë publik kundër përfshirjes në qeveri, ndërsa ka paralajmëruar se partia nuk dëshiron që Kosova

ABDIXHIKU I SHPËTON SHKARKIMIT, SHPREHET I HAPUR PËR VAZHDIMIN E BISEDIMEVE ME LV-në

Lumir Abdixhiku ka mbetur në krye të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), pasi ka marrë mbështetjen e shumicës së delegatëve në Kuvendin e jashtëzakonshëm të partisë. Pas votimit, Abdixhiku ka deklaruar se LDK-ja është e gatshme të rifillojë bisedimet me Lëvizjen Vetëvendosje për formimin e institucioneve të reja, duke theksuar se vendi ka nevojë për stabilitet institucional

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 31 KORRIK - Lumir Abdixhiku ka mbetur në krye të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), pasi ka marrë mbështetjen e shumicës së delegatëve në Kuvendin e Jashtëzakonshëm të partisë. Nga 327 vota të vlefshme, 170 delegatë votuan kundër shkarkimit të tij, 152 pro, ndërsa pesë abstenuan. Pas përfundimit të procesit, Abdixhiku ka deklaruar se LDK-ja do të rifillojë bisedimet me Lëvizjen Vetëvendosje për formimin e institucioneve të reja, duke theksuar nevojën për stabilitet institucional. "Nga sot e heq atë pezullimin dhe LDK-ja është e hapur të diskutojë tutje për institucionet", ka thënë Abdixhiku.

Ai kishte pezulluar komunikimin me kryetarin e LV-së, Albin Kurtin, pas dorëzimit të nënshkrimeve për shkarkimin e tij nga kreu i LDK-së. Dy liderët, së bashku me ish-presidenten Vjosa Osmani, ishin takuar më 10 korrik për të diskutuar formimin e institucioneve të reja, por takimi nuk kishte prodhuar marrëveshje konkrete.

Abdixhiku ka thënë se LDK-ja është e gatshme për një marrëveshje që garanton balancë institucionale, duke kundërshtuar një skenar ku Kuvendi, Qeveria dhe Presidenca do të kontrolloheshin nga një subjekt i vetëm politik. "E rëndësishme është që të shmangen zgjedhjet. Populli nuk do më zgjedhje të reja. Do stabilitet institucional", ka deklaruar ai.

Seanca konstituive e legjislaturës së re është caktuar për 6 gusht. Me konstituimin e Kuvendit nis edhe afati 60-ditor për zgjedhjen e presidentit të ri. Për zgjedhjen e presidentit kërkohet prania e të paktën 80 deputetëve në dy rundet e para të votimit, ndërsa një marrëveshje mes LV-së dhe LDK-së do të mundësonte sigurimin e numrave të nevojshëm.

Abdixhiku ka thënë se nuk mund t'u kërkojë 18 deputetëve të LDK-së të mbështesin një marrëveshje që ende nuk është arritur, por ka theksuar se koha për një marrëveshje është e kufizuar. "Janë vetëm edhe 60 ditë që të



arrihet një marrëveshje. Nëse nuk arrihet, do të ishte fatkeqësi", ka thënë ai.

Abdixhiku ka deklaruar gjithashtu se nuk do të ketë hakmarrje ndaj atyre që mbështetën nismën për shkarkimin e tij, ndërsa ka bërë thirrje për bashkimin e partisë. "Nuk do të ketë hakmarrje, por rrugën s'mund ta bësh me ata që nuk besojnë", ka thënë Abdixhiku. Ai e ka cilësuar Kuvendin e 30 korrikut si një nga momentet më të vështira në historinë e LDK-së, duke premtuar se do të punojë për ta bashkuar partinë, pa bërë kompromis me vlerat e saj. Pas konfirmimit të Abdixhikut në krye të partisë ka reaguar edhe ish-presidentja Vjosa Osmani, e cila ka shkruar në Facebook: "Jo çdo fitore është e zakonshme. Disa fitore bëhen frymëzim. Kjo është njëra prej tyre!". Ndërkohë, deputeti i zgjedhur i LDK-së, Armend Zemaj, i cili kishte mbështetur mocionin për shkarkimin e Abdixhikut, e ka pranuar rezultatin e votimit. "Ky është rezultati. Gjithçka ishte demokratike dhe partia doli e bashkuar", ka deklaruar Zemaj.

Gjatë fjalimit para delegatëve, Abdixhiku e kishte cilësuar nismën për shkarkimin e tij si "të gabuar, të pavend dhe të pakohë". Ai kishte argumentuar se zgjedhjet e rregullta partiake ishin afër dhe se nuk kishte nevojë për një proces të jashtëzakonshëm.

Abdixhiku kishte thënë se përgjegjësinë për rezultatin zgjedhor duhet ta mbajnë ata që ishin aktivë në fushatë, duke kritikuar njëkohësisht figurat që, sipas tij, kishin refuzuar të merrnin pjesë në aktivitetet dhe organet e partisë.

Nisma për shkarkimin e tij ka ardhur pas rezultatit të LDK-së në zgjedhjet e qershorit, ku partia doli e treta dhe siguroi 18 ulëse në Kuvendin e Kosovës. Pas zgjedhjeve, disa kryetarë komunash dhe drejtues të degëve kërkuan publikisht dorëheqjen e Abdixhikut, duke e bërë përgjegjës për rezultatin zgjedhor.

Abdixhiku është përballur me thirrje për dorëheqje edhe në janar, pas zgjedhjeve të mbajtura në fund të vitit të kaluar, por atëherë kishte marrë votëbesimin e delegatëve të partisë. LDK-ja

është themeluar në vitin 1989 nga Ibrahim Rugova dhe ka luajtur rol të rëndësishëm në rezistencën paqësore dhe në ndërtimin e institucioneve demokratike të Kosovës.

Haxhiu: Rizgjedhja e Abdixhikut hap rrugën për vazhdimin e takimeve për presidentin

Ushtruesja e detyrës së presidentes, Albulena Haxhiu, e ka mirëpritur rizgjedhjen e Lumir Abdixhikut në krye të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), duke e cilësuar këtë zhvillim si mundësi për rifillimin e takimeve ndërmjet partive politike për çështjen e zgjedhjes së presidentit të vendit. Haxhiu ka thënë se përfundimi i Kuvendit të jashtëzakonshëm të LDK-së ka qartësuar situatën brenda partisë, duke hapur rrugën për vazhdimin e dialogut politik. Ajo ka theksuar se nuk i takon asaj të komentojë proceset e brendshme të LDK-së, por ka vlerësuar se është e rëndësishme që takimet ndërmjet partive të rifillojnë sa

më shpejt. "Së pari, është lajm i mirë që tashmë kemi pasur një mbledhje të LDK-së dje. Pra, lajm i mirë në kuptimin që tashmë mund të vazhdojnë takimet, sepse, siç e dini, ato janë të pezulluara deri në qartësimin e situatës brenda LDK-së. Sigurisht që nuk është në mandatin tim, as në përgjegjësitë e mia, sidomos jo në cilësinë që jam, të flas për atë çështje, por është shumë e rëndësishme që takimet të vazhdojnë. Pra, ato të fillojnë dhe të mbahen", ka deklaruar Haxhiu.

Ajo ka bërë thirrje për angazhim maksimal dhe seriozitet nga të gjitha palët, në mënyrë që të arrihet një marrëveshje politike me konsensus për zgjedhjen e presidentit ose presidentes së Republikës së Kosovës. "Është shumë e rëndësishme që të ketë përpjekje maksimale, seriozitet, që të arrihet një marrëveshje me të cilën arrijmë të kemi një konsensus për zgjedhjen e presidentit apo presidentes së vendit. Pra, është shumë e rëndësishme që këto takime të vazhdojnë sa më parë", ka thënë Haxhiu.

të hyjë në një tjetër cikël zgjedhor. "Jemi të vetmit që kemi një pozicion publik në raport me konstituimin. S'duam të jemi pjesë e qeverisë, s'të marrim as hise, as

privilegj, asnjë pozitë në qeveri. Mirëpo, ne e njohim rrezikun që Kosova të përfundojë nga një cikël zgjedhor në një cikël tjetër. E shohim si rrezik të shtetësisë së

Kosovës", ka thënë Tahiri pas takimit me Haxhiun. Ai ka theksuar se AAK-ja ka paraqitur gjashtë pika, të cilat, sipas tij, nuk lidhen me interesat e partisë, por me të

ardhmen e Kosovës. "Ne kemi thënë, s'duam zgjedhje, por për t'i konstituuar institucionet, ne kemi gjashtë pika. Ato s'lidhen me Aleancën. Ndërlidhen me Kosovën", ka deklaruar Tahiri.

Deputeti i AAK-së ka paralajmëruar se, nëse kërkesat e partisë nuk merren parasysh, ajo nuk do të mbështesë një marrëveshje që e shoh si të papërshtatshme.

NUK ËSHTË FUNDI I BOTËS!



Shkruan: Behxhet
Sh. SHALA - BAJGORA

Kush humbi e kush fitoi?:

Kuvendi i jashtëzakonshëm i LDK-së përfundoi ashtu si e kam paraparë. Lumir Abdixhiku mbijetoi duke u konfirmuar si kryetar deri në kuvendin e rregullt zgjedhor në vitin 2027. Krahë që kërkoi shkarkimin e Abdixhikut përfaqëson mbi 45 të votuesve të LDK-së, prandaj kjo fitore e Abdixhikut është “fitore e Pirros”. Krahë kundërshtues nuk kishte përkrahje thuaja nga askush dhe argumenti për të cilin menduan se mjafton për ta shkarkuar Abdixhikun ishte përkushtimi ndaj partisë një pjesë e të cilëve ishin anëtarë thuaja nga themelimi i partisë (dhjetor 1989). Ndërkaq krahë i Abdixhikut përveç përkrahësve (afërsisht 55 për qind) e kishte përkrahjen absolute të lulegjelave të LV-së me krye lulegjinin suprem, Albin Kurthi. Dhe të një personi dinak, të keq dhe pa asnjë skrupull kur është në pyetje pushteti dhe interesi

personal, “Vejusha e Zezë”, Vjosa Osmani, politikisht, me të drejtë e përdhunuar nga Kurthi. Po përfolet për shumta të mëdha parash, poste dhe favore tjera që do të përfitonin nëse e shpëtojnë kokën politike të Abdixhikut. Albini e përkrahë, Glauk Pinokio Konjufca gjithashtu, Adriana Matoshka, Arbresha Kokëziu, Adnan Rrusta, Lenka Quko e Maqellarës, ndërsa në planin logjistik fort u angazhua një person me trup të madh dhe tru ekstremisht të vogël, dashamir i barit (nuk është vegjetarian si do të mendoni) dhe organizator i orgjive për miq dhe bashkëpartiak. Makro politik. Budalla që jeton shkëlqyeshëm nga prostitucioni politik. Rrenc dhe mashtrues enciklopedik.

Si tutje: Lumir Abdixhiku pasi i shpëtoi gijotinës politike tha se nuk ka hakmarrje për askënd. Përveç Përparim Ramës të cilin po të kishte mundësi do ta ngulte në hu sikur dikur jeniçerët turq që bënë me kundërshtarët e tyre! Lumir Abdixhiku tani

është në situatë më të rëndë se para Kuvendit të jashtëzakonshëm, përfundimisht nuk e kontrollin gjysmën e partisë. Me kalimin e kohës do ta humbë edhe më shumë përkrahjen nëse krahë kundërshtues qëndron i bashkuar. Proceset në të ardhmen do të jenë të rënda, marrëveshja me Serbinë e Brukselit dhe Ohrit do të sjellë situata ku shapi ndahet prej sheqeri, kallaji nga ari dhe baroti nga m... Lumir Abdixhiku dhe Vojsa Osmani do të jenë rrogëtarë të Kurthit, për një bythë karrike. Këtyre nuk iu intereson as Kombi e as Shteti sepse nuk kanë dhënë asnjë kontribut përveç se janë përfitues parazit dhe patologjik. Albin Kurthi ia dinë shijen dhe grykësinë andaj iu ofronë një meny që e duan. Lumi dhe Voca, si Boni dhe Kllajd janë çift i përkryer për një skenë të kriminalizuar politike siç është në Kosovë prandaj paraqesin lëndë të parë të shkëlqyer për përpunim dhe riciklim të servilizmit antikombëtar, antishtet për një helmues të

jashtëzakonshëm midis shqiptarëve siç është Çezare Borxhia i Kosovës - Albin Kurthi. Nëse krahë i Gazit dhe Imrisë e menaxhojnë mirë situatën do të jenë më të fuqishëm se para Kuvendit. Asnjë nuk duhet të japin dorëheqje nga LDK-ja sepse nuk kanë arsye. Deri në kuvendin e rregullt duhet të pajtohen se Abdixhiku është kryetar e që nuk nënkupton se do ta përkrahin apo e votojnë çdo propozim dhe marrëveshje të Abdixhikut. Qëllimi është që Abdixhiku të sillet si satelit rreth Kurthit, kurse Vojsa Osmani ta merr LDK-në. Këtë nuk duhet lejuar me asnjë çmim. Nëse Abdixhiku arrin një marrëveshje të mirë për Kosovën dhe LDK-në me Kurthin, duhet ta përkrahin. Krahë i Gazit dhe Imrisë mund të kenë 6 deri 8 deputetë e që do të jenë përcaktues për çdo vendim për vendin. Nëse bien në kurth të Abdixhikut që e shpalli një “amnist” për krahun kundërshtues, përjashtuar Përparim Ramën, do të përçahen dhe

një nga një do të eliminohen nga dyshja antikomb dhe antishtet, Lumi dhe Voca - Boni dhe Kllajd. Këtyre nuk u intereson LDK-ja dhe Kosova prandaj janë të gatshëm që LDK-në ta bëjnë si nëndegë të “Guxo”-s. Krahë i Gazit dhe Imrisë duhet të takohet shpejtë duke vendosur kushte dhe kriteret se a do ta përkrahin apo jo Abdixhikun. Abdixhiku e ka të qartë se pas Gazit në Pejë nuk ka pushtet të LDK-së, as në Lipjan pas Imrisë dhe në Prishtinë pa Përparimin. E provoi me Ekremi në Podujevë, pësoi fijasok, ashtu edhe me Visarin në Ferizaj. Luto “Fukaraja” është më i zoti se Noa, varka e të cilit u përmbysë. Varka e Lutës po përballon çdo përmbysjeje të LDK-së. Dukuri interesante. Tash e tërë beteja do të bëhet kundër Përparim Ramës, aktualisht është i vetmi lider me dije, qëndrim, veprim, guxim dhe koçë opozitare. Prandaj po sulmohet aq shumë. Prandaj nuk ka vend për dëshpërim!

KUR ODISEU I FLET NJERIUT TË SOTËM

Lulëzim ETEMAJ

Ka vepra që nuk plaken kurrë. Ato nuk i përkasin vetëm kohës kur u krijuan, por çdo epoke që përpigjet të kuptojë njeriun, luftën, humbjen dhe shpresën e tij. Poema epike e Homerit, “Odisea”, një nga kryeveprat më të vjetra të letërsisë botërore, është njëra prej tyre. Për më shumë se tre mijë vjet ajo ka frymëzuar breza lexuesish, artistësh dhe studiuesish. Tani Christopher Nolan e rikthen këtë epike të jashtëzakonshme në ekran, duke e shndërruar atë në një përvojë moderne kinematografike.

Për ta kuptuar më mirë filmin, duhet të kujtojmë fillimisht se kush ishte Odiseu. Ai ishte mbreti i Itakës dhe një nga figurat më të rëndësishme të Luftës së Trojës. Ndryshe nga ata heronjtë që mbështeten kryesisht te forca e tyre fizike, Odiseu dallohet për zgjuarsinë, strategjinë dhe aftësinë për ta fituar betejën jo vetëm me shpatë, por edhe me mendje. Tradita mitologjike ia atribuon atij edhe idenë e Kalit të Trojës, mashtrimin e paraqitur në formën e një dhurate, që çoi në rënien e këtij qyteti.


Nga miti i Kalit të Trojës u bë e njohur edhe thënia e Virgjilit: “Kam frikë nga grekët (danajt), edhe kur sjellin dhurata”. Ajo vazhdon të përdoret edhe sot si paralajmërim se pas një gjesti në

dukje bujar mund të fshihen mashtrimi, interesat dhe prapaskenat.

Por fitorja në luftë nuk është fundi i historisë së tij. Sfida e vërtetë fillon pikërisht pas saj, kur ai nisat drejt Itakës. Udhëtimi që, sipas Homerit, zgjat dhjetë vjet, e vendos atë përballë Ciklopit Polifem, Sirenave, Circes, Kalipsës dhe një mori sprovash që tejkalojnë kufijtë e fantazisë. Në thelb, këto nuk janë thjesht aventura mitologjike; ato janë sprova morale që tregojnë se kthimi në shtëpi mund të jetë më i vështirë sesa fitimi i një luftime.

Pikërisht këtu Nolan vendos theksin e tij. Filmi nuk e trajton Odiseun vetëm si një luftëtar legjendar, por si një njeri të plagosur nga lufta, që bart peshën e zgjedhjeve të veta dhe përpigjet të rikthehet në Itakë, por edhe te vetja. Përtej spektaklit të përbindëshave dhe betejave, regjisori kërkon të zbulojë pasojat psikologjike të luftës dhe gjurmët që ajo lë në shpirtin e njeriut.

Në këtë pikë qëndron edhe shtresa më e thellë simbolike e filmit. Kthimi në Itakë nuk është një fund i lumtur në kuptimin klasik. Është një rikthim fizik, por jo domosdoshmërisht një rikthim i plotë shpirtëror. Lufta e Trojës e ka ndryshuar Odiseun përgjithmonë dhe ai nuk mund të jetë më njeriu që ishte para nisjes. Në njëfarë mënyre, lufta e ka bërë edhe atë një të burgosur



të saj.

Edhe kur mbërrin në shtëpi, Odiseu mbetet në një farë mënyre i mërguar brenda vetes. Në interpretimet e mëvonshme të mitit, pas kthimit në Itakë ai do të ndërmarrë një tjetër udhëtim, si një akt pajtimi me hyjnitë dhe me fatin e tij. Kështu, ai bëhet simboli i njeriut që udhëtimin më të vështirë nuk e bën nëpër dete, por brenda vetes.

Po aq domethënës është edhe raporti i tij me bashkëluftëtarët e vranë. Odiseu është një nga të paktët që kthehet nga Troja. Gjatë rrugës i humb të gjithë shokët e tij dhe bëhet bartësi i kujtesës së tyre. Prandaj kthimi në Itakë nuk është vetëm një fitore personale; është edhe një akt nderimi për ata që nuk patën mundësinë të ktheheshin. Ai mbijeton, por mbijetesa e tij ka një çmim: barrën e kujtesës. Në këtë kuptim, Odiseu nuk është vetëm fitimtari i Trojës; ai është

dëshmitari i brezit të tij.

Vizualisht, filmi është shumë mbresëlënës. Peizazhet monumentale, ritmi i rrëfimit dhe mënyra se si Nolan ndërton tensionin krijojnë një atmosferë epike, por duke e ruajtur dimensionin njerëzor të historisë. Personazhet nuk janë vetëm figura mitologjike; ata mbartin plagët e luftës, mallin për shtëpinë dhe dilemën morale që lind pas çdo fitoreje. Në atë atmosferë epike pati edhe një detaj që më befasoi këndshëm. Mes orkestrimit madhështor dallova tinguj që më dukeshin çuditërisht të afërt: jehonën e fyellit shqiptar.

Në fillim nuk më besohej se po dëgjoja tinguj të traditës sonë në një film të përmasave botërore. Ishte një ndjesi e veçantë. Më bëhej sikur një copëz e zërit të maleve tona krenare të kishte udhëtuar larg dhe të kishte gjetur vendin e saj në një nga tregimet

më të mëdha të njerëzimit.

Kjo më shtyu ta verifikoja. Dhe befasia ishte edhe më e bukur. Konfirmimi që mora ishte ky: Vendim Kapaj, së bashku me grupin Djemtë e Delvinës, ka marrë pjesë si solist me fyellin e tij tradicional shqiptar të barinjve në kolonën zanore të filmit. Sipas informacioneve të publikuara, kompozitori ka udhëtuar edhe në jug të Shqipërisë për të regjistruar këta tinguj autentikë, duke kërkuar atë frymë të lashtë dhe natyrore që mbart ky instrument. Në atë moment, muzika për mua nuk ishte më thjesht një shoqërim i figurave në ekran. Ajo u bë një urë mes kohëve dhe kulturave: mes botës së Homerit, Mesdheut të përbashkët dhe shpirtit të një tradite shqiptare që përkundër sfidave të shumta vazhdon të jetojë.

Në fund, “Odiseu” nuk është vetëm një film për një hero të lashtësisë. Ai është një reflektim mbi luftën dhe pasojat e saj, mbi besnikërinë, humbjen dhe identitetin. Nolan nuk e trajton mitin si një relik, por si një histori që vazhdon t’i flasë njeriut të sotëm.

Sepse Itaka, në fund të fundit, nuk është vetëm një vend gjeografik. Ajo është simboli i paqes që secili kërkon, por që askush që ka kaluar nëpër flakët e luftës nuk e gjen plotësisht. Kjo e bën historinë e Odiseut të mbetet, edhe pas mijëra vitesh, universale dhe thellësisht njerëzore.

BASHKËPUNIMI KOSOVË-SHBA, “ALBANIANS FOR AMERICA” KËRKON RIFILLIMIN E DIALOGUT STRATEGJIK

PRISHTINË, 31 KORRIK - Delegacioni i organizatës “Albanians for America” ka zhvilluar një takim me të ngarkuarën me punë në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Anu Prattipati, ku është diskutuar për forcimin e partneritetit ndërmjet Kosovës dhe ShBA-së, si dhe për thellimin e bashkëpunimit në disa sektorë strategjikë.

Delegacioni i AFA-së, i përbërë nga Gino Mulliqi, Gëzim Rushiti dhe Janinë Memeti, së bashku me përfaqësuesen amerikane, kanë riafirmuar rëndësinë e marrëdhënieve të ngushta ndërmjet dy vendeve dhe nevojën për avancimin e bashkëpunimit në fusha me interes të përbashkët.

Gjatë takimit, vëmendje e veçantë i është kushtuar zgjerimit të bashkëpunimit ekonomik, rritjes së investimeve amerikane në Kosovë dhe zhvillimit të sektorit të energjisë, përfshirë projektet që lidhen me gazin natyror të lëngshëm. Po ashtu, është diskutuar edhe për krijimin e vendeve të reja të punës përmes investimeve strategjike. Përfaqësuesit e AFA-së kanë theksuar se funksionimi i institucioneve dhe qeverisja e



qëndrueshme janë faktorë kyç për rritjen e besimit të investitorëve dhe zhvillimin afatgjatë ekonomik të Kosovës. “Forcimi i institucioneve dhe qeverisja e qëndrueshme janë thelbësore për rritjen e besimit të investitorëve dhe zhvillimin ekonomik të vendit”, kanë

theksuar përfaqësuesit e AFA-së. Në kuadër të diskutimeve, delegacioni ka bërë thirrje edhe për rifillimin e dialogut strategjik Kosovë-ShBA, duke e cilësuar atë si një mekanizëm të rëndësishëm për koordinim dhe bashkëpunim afatgjatë në fushat e sigurisë, ekonomisë,

energjisë dhe zhvillimit institucional. Gjithashtu, është nënvizuar kontributi i komunitetit shqiptaro-amerikan në forcimin e lidhjeve ndërmjet Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara, si dhe në krijimin e mundësive të reja për investime dhe zhvillim

ekonomik. Në përfundim të takimit, delegacioni i “Albanians for America” ka shprehur mirënjohje për mbështetjen e vazhdueshme që ShBA-ja i ka dhënë Kosovës ndër vite, duke riafirmuar përkushtimin për thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit dypalësh.

RAMA: LAJM I MIRË QË LV-ja PO I DREJTOHET PROKURORISË, UDHËZOJENI EDHE KRYEMINISTRIN T'I PËRGJIGJET

PRISHTINË, 31 KORRIK - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka reaguar lidhur me kallëzimin penal që asamblistët e Lëvizjes Vetëvendosje kanë dorëzuar në Prokurorinë Speciale, duke pretenduar për përfshirje të tij dhe zyrtarëve të lartë të komunës në legalizime të kundërligjshme të objekteve. Përmes një postimi në rrjetet sociale, Rama ka thënë se e mirëpret faktin që rasti është dërguar në prokurori.

"E para, po m'vjen mirë që më në fund po i drejtoheni

Prokurorisë. Është lajm i mirë", ka shkruar ai.

Rama ka bërë edhe një koment politik, duke i kërkuar kryeministrit që t'i përgjigjet ftesës së prokurorisë. "Tash udhëzojeni edhe kryeministrin t'i përgjigjet Prokurorisë, sepse ka më shumë se dy vjet që nuk i përgjigjet ftesës për intervistim", është shprehur ai.

Kryetari i Prishtinës ka ritheksuar se komuna do të vazhdojë të jetë e hapur për bashkëpunim me organet e drejtësisë. "Dyert e kryeqytetit kanë qenë dhe mbeten të

hapura për organet e drejtësisë. Garantojmë bashkëpunim të plotë, transparent dhe institucional për çdo kërkesë të Prokurorisë, si gjithmonë, pa diskutim", ka deklaruar Rama.

Ai ka përsëritur se, pas vendimit të prokurorisë, do të ndërmerren të gjitha veprimet ligjore ndaj çdo personi që rezultojnë se ka shkelur ligjin. "Pas vendimit të Prokurorisë, do t'i ndërmarrim pa asnjë hezitim të gjitha veprimet dhe procedurat ligjore ndaj kujtdo që rezultojnë se ka shkelur ligjin", ka përfunduar ai.



NIS GJYKIMI NË MUNGESË KUNDËR 21 TË AKUZUARVE PËR MASAKRËN E REÇAKUT

Një gjykim në mungesë ka nisur të premten në Gjykatën Themelore në Prishtinë ndaj 21 personave të akuzuar për krime lufte kundër popullatës civile në masakrën e Reçakut. Të pandehurit, me inicialet O.S., R.M., K.J., G.R., Zh.T., B.J., M.L., R.M., D.G.J., B.M., D.J., M.SH., D.A., S.V., B.M., Z.S., M.J., G.P., D.N. dhe Ç.A., akuzohen se, gjatë një operacioni të forcave policore dhe ushtarake serbe në vitet 1998-1999, kanë marrë pjesë në vrasjen e 42 civilëve në Reçak të Shtimes, rreth 30 kilometra larg Prishtinës.

Prokuroria ka kërkuar që procesi gjyqësor të zhvillohet në mungesë, pasi të akuzuarit konsiderohen të paarritshëm për organet e drejtësisë së Kosovës. Seanca e parë ishte paraparë të mbahej më 20 korrik, por Gjykata Themelore në Prishtinë e kishte shtyrë atë për shkak të mungesës së kushteve ligjore.

Ramë Shabani, i mbijetuar i masakrës së Reçakut, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se, edhe nëse të akuzuarit shpallen fajtorë dhe dënohen, drejtësia nuk do të jetë e plotë. "Unë jam



që të ketë verdikt të drejtë. Por, kjo nuk mund të sjellë drejtësi. Ata 21 persona, të cilëve u janë përmendur emrat, nuk hyjnë më në Kosovë dhe ne (autoritetet e Kosovës) nuk do të mund t'i kapim kurrë... Pa qenë ata në bankën e të akuzuarve, nuk mund të bësh asgjë", ka deklaruar ai.

Gjykimi në mungesë është i mundur në Kosovë pas ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale të vitit 2022. Megjithatë, një proces i tillë mund të zhvillohet vetëm pasi

prokuroria dhe gjykata t'i kenë shteruar të gjitha mundësitë për sigurimin e pranisë së të akuzuarit. Kodi përcakton gjithashtu se personat e dënuar në mungesë kanë të drejtë për rigjykim pa kushte në rast se arrestohen më vonë.

Sipas aktakuzës, 21 të akuzuarit, si pjesëtarë të Ushtrisë së ish-Jugosllavisë, Brigadës së 243-të të Mekanizuar të Armatës së III-të, të njohur si "Korpusi i Prishtinës", dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, gjatë luftës së viteve

1998-1999 dyshohet se kanë kryer trajtim çnjerëzor, shkatërrim të pasurisë, dëbim masiv dhe spastrim etnik ndaj popullatës civile.

Prokuroria pretendon se forcat serbe e kishin rrethuar Reçakun nga drejtimet e njohura si "Pishat", "Gështenjat" dhe "Çesta", para se ta granatonin fshatin. Më pas, sipas aktakuzës, ata kishin kontrolluar shtëpitë një nga një, kishin ndarë burrat nga gratë dhe fëmijët dhe kishin urdhëruar këta të fundit të largoheshin nga fshati, ndërsa burrat e ndaluar dyshohet se ishin ekzekutuar.

Në lidhje me masakrën e Reçakut, më 12 qershor, gjatë një operacioni të përbashkët të Prokurorisë Speciale dhe Policisë së Kosovës, në kuadër të hetimeve për rastin "Reçaku II", ishin arrestuar pesë persona të nacionalitetit serb. Një person i gjashtë, po ashtu i dyshuar në këtë rast, nuk ishte gjetur në vendbanimin e tij.

Të arrestuarit dyshohen se kanë qenë pjesë e njësisë speciale të policisë serbe që morën pjesë në operacionin e janarit 1999 në Reçak. Masakra e Reçakut ishte

dokumentuar nga William Walker, i cili në atë kohë drejtonte Misionin Verifikues të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Ngjarja shkaktoi reagim të fuqishëm ndërkombëtar dhe rriti trysinë ndaj regjimit të atëhershëm në Serbi, duke kontribuar në zhvillimin e bisedimeve të Rambujesë mes përfaqësuesve të shqiptarëve të Kosovës dhe autoriteteve serbe.

Pas dështimit të arritjes së një marrëveshjeje, NATO ndërmori fushatën ajrore ndaj caqeve ushtarake dhe policore të ish-Jugosllavisë, e cila zgjati 78 ditë. Pas përfundimit të bombardimeve, forcat ndërkombëtare hynë në Kosovë, ndërsa forcat dhe administrata serbe u larguan nga vendi.

Instituti i Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë ka dokumentuar 12 230 viktima të luftës së viteve 1998-1999. Ndërkohë, më herët gjatë këtij viti, Prokuroria Speciale kishte ngritur aktakuzë në mungesë ndaj 21 të dyshuarve për dëbimin me forcë të mbi 800 mijë civilëve shqiptarë nga Kosova gjatë luftës.

ARRESTOHET NË KOSOVË NJË I KËRKUAR NGA INTERPOLI, PËRDORTE IDENTITETIN E NJË PERSONI TË VDEKUR

PRISHTINË, 31 KORRIK - Prokuroria dhe Policia e Kosovës kanë zbuluar një rast të rëndë të keqpërdorimit të identitetit, i cili ka çuar në arrestimin e një shtetasi shqiptar të kërkuar ndërkombëtarisht për vrasje dhe vepra të tjera të rënda penale.

Sipas njoftimit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, operacioni është zhvilluar në koordinim me Drejtorinë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit (DHKEK) të Policisë së Kosovës, si dhe me partnerët ndërkombëtarë të zbatimit të ligjit.

Hetimet kanë nisur më 17 qershor 2026, kur një person me inicialet B.K. është paraqitur në

Agjencinë e Regjistrimit Civil (ARC) për të vazhduar dokumentet e identifikimit. Gjatë verifikimit, zyrtarët kanë zbuluar se identiteti i përdorur i përkiste një personi që kishte vdekur prej shumë vitesh, duke ngritur dyshime për keqpërdorim të identitetit.

I dyshuari është shoqëruar në polici dhe është intervistuar në prani të avokatit, por ka zgjedhur të mos japë deklaratë. Me urdhër të Prokurorit të Shtetit, ai është ndaluar për 48 orë, ndërsa më pas Gjykata ka caktuar masën e paraburgimit. Për verifikimin e identitetit të tij të vërtetë, autoritetet kosovare kanë aktivizuar bashkëpunimin ndërkombëtar përmes

Interpolit dhe Europolit, duke shpërndarë të dhënat biometrike dhe gjurmët e gishtërinjve.

Nga informacionet e marra nga autoritetet e Gjermanisë, Francës, Austrisë, Belgjikës, Shqipërisë, Hungarisë dhe shteteve të tjera partnere, është konfirmuar se i dyshuari kishte përdorur pesë identitete të ndryshme, të lidhura kryesisht me Greqinë, Shqipërinë dhe Kosovën, me të cilat kishte vepruar dhe udhëtuar në disa vende evropiane.

Si rezultat i hetimeve të mëtejshme dhe bashkëpunimit me autoritetet e Gjermanisë dhe Shqipërisë, është identifikuar se personi i arrestuar është shtetasi



shqiptar me inicialet E.K., i cili kërkohej me njoftim të kuq (Red Notice) nga Interpoli.

Autoritetet shqiptare kanë konfirmuar se E.K. është i

dënuar me 17 vjet burgim për veprat penale "Vrasje" dhe "Shtërëngim me anë të kanosjes ose dhunës për dhënie të pasurisë".

KOSOVA REGJISTRON MË PAK BIZNESE TË REJA, RËNIE MBI 5 PËR QIND BREND A NJË VITI

PRISHTINË, 31 KORRIK - Numri i ndërmarrjeve të reja të regjistruara në Kosovë ka vazhduar të shënojë rënie edhe gjatë muajit qershor 2026, duke reflektuar një ngadalësim të ritmit të hapjes së bizneseve.

Të dhënat e publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) tregojnë se regjistrimet e reja kanë rënë si në krahasim me muajin paraparak, ashtu edhe me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Sipas ASK-së, në muajin qershor janë regjistruar gjithsej 1 mijë e 92 ndërmarrje të reja, ose 1.4 për qind më pak krahasuar me muajin maj 2026.

Rënia është edhe më e theksuar në krahasim me qershorin e vitit 2025, kur numri i bizneseve të reja rezultoi të jetë 5.1 për qind më i ulët.

Pavarësisht rënies së përgjithshme, sektori i tregtisë vazhdon të mbetet aktiviteti ekonomik më tërheqës për sipërmarrësit. Gjatë qershorit, 242 ndërmarrje, ose 22.2 për qind e totalit të bizneseve të reja, janë regjistruar në aktivitetet e tregtisë me shumicë dhe pakicë, si dhe riparimit të automjeteve dhe motoçikletave. Pas tregtisë,

numri më i madh i regjistrimeve është evidentuar në sektorin e akomodimit dhe shërbimeve të ushqimit, me 124 ndërmarrje, ose 11.4 për qind të totalit.

Në vendin e tretë renditet ndërtimtaria me 121 ndërmarrje, ose 11.1 për qind, ndërsa aktivitetet profesionale, shkenore dhe teknike përbëjnë 114 ndërmarrje, ose 10.4 për qind të regjistrimeve të reja. Të dhënat tregojnë gjithashtu se bizneset e reja vazhdojnë të jenë pothuajse ekskluzivisht mikro-ndërmarrje. Nga 1 mijë e 92 ndërmarrjet e regjistruara në qershor, 1 mijë e 88 i përkasin kategorisë me 0 deri në 9 të punësuar, ndërsa vetëm katër janë regjistruar si ndërmarrje të vogla me 10 deri në 49 punëtorë. Gjatë këtij muaji nuk është regjistruar asnjë ndërmarrje e mesme apo e madhe, çka tregon se investimet në biznese me kapacitete më të mëdha vazhdojnë të mungojnë. Edhe forma ligjore e organizimit mbetet pothuajse e pandryshuar. Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar (Sh.P.K.) dominojnë bindshëm me 78,57 për qind të gjitha regjistrimeve të reja, ndërsa bizneset individuale përbëjnë



20.88 për qind. Format e tjera ligjore, si kompanitë e huaja, shoqëritë aksionare, ndërmarrjet publike, kooperativat bujqësore apo zyrat e përfaqësive, kanë një pjesëmarrje minimale ose nuk kanë pasur fare regjistrime gjatë muajit qershor. Sa i përket shpërndarjes gjeografike, rajoni i Prishtinës vazhdon të dominojë me 536 ndërmarrje të reja, që përfaqësojnë 49,1 për qind të totalit. Pas tij renditen Ferizaj me 115 ndërmarrje (10.5 për qind), Prizreni me 109 (10 për qind), Gjilani me 97 (8.9 për qind),

Peja me 90 (8,2 për qind), Mitrovica me 85 (7.8 për qind) dhe Gjakova me 60 ndërmarrje, ose 5.5 për qind të totalit. Në nivel vendi, rënia ishte prej 16 bizneseve, por disa qendra shënuan rritje. Prishtina kaloi nga 523 në 536 regjistrime, Peja nga 76 në 90, Gjilani nga 86 në 97 dhe Ferizaj nga 110 në 115. Në anën tjetër, ulje u vunë re në Gjakovë, nga 83 në 60 regjistrime, në Prizren, nga 130 në 109, dhe në Mitrovicë, nga 100 në 85.

Kryeqyteti vazhdon të përqendrojë peshën kryesore të

ekonomisë vendase, duke mbuluar 49.1 për qind të të gjitha regjistrimeve të qershorit. Pavarësisht luhatjeve rajonale, struktura e bizneseve sipas madhësisë mbetet pothuajse e pandryshuar, e dominuar plotësisht nga mikro-ndërmarrjet. Nga 1 mijë e 92 bizneset e regjistruara në qershor, 1 mijë e 88 kanë nga 0 deri në 9 të punësuar, kurse vetëm katër hyjnë në kategorinë me 10 deri në 49 punëtorë. Asnjë ndërmarrje e madhësisë së mesme apo të madhe nuk është regjistruar gjatë muajit.

MINTI: ARBK-ja PUBLIKON VETËM TË DHËNAT QË LIGJI I PËRCAKTON SI PUBLIKE



PRISHTINË, 31 KORRIK - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI) ka reaguar pas shqetësimeve të shprehura ditë më parë nga biznese të

ndryshme lidhur me publikimin e të dhënave nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK). Në një deklaratë, MINTI ka thënë se publikimi i të dhë-

nave nga Regjistri i Bizneseve bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe ka për qëllim rritjen e transparencës dhe sigurisë juridike në veprimtarinë ekonomike. "Regjistri i

Bizneseve është regjistër publik, i krijuar dhe i administruar për të garantuar transparencën e veprimtarisë ekonomike, sigurinë juridike në qarkullimin tregtar dhe për të mundësuar qasjen në informacionet që, sipas ligjit, kanë karakter publik", është thënë në reagimin e MINTI-t.

Sipas MINTI-t, publikimi i të dhënave mbështetet në Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe bëhet duke respektuar edhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. "ARBK-ja thekson se publikon vetëm ato të dhëna të cilat legjislacioni i përcakton si të dhëna publike. Të dhënat personale ose informacionet e tjera që nuk janë të destinuara për publikim mbrohen dhe trajtohen në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe nuk bëhen pjesë e qasjes publike",

është thënë në reagim.

MINTI ka bërë të ditur se qëllimi i publikimit është lehtësimi i verifikimit të statusit juridik të bizneseve, forcimi i sigurisë juridike në marrëdhëniet ekonomike dhe rritja e besueshmërisë në të bërit biznes.

"Qëllimi i publikimit të të dhënave është të rritet transparencja dhe besueshmëria e të bërit biznes, të lehtësohet verifikimi i statusit juridik të subjekteve afariste, të forcohet siguria juridike në marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare", është thënë në deklaratë.

Në fund, MINTI ka ftuar bizneset dhe qytetarët që të dhënat publike nga regjistri i bizneseve t'i përdorin vetëm për qëllime të ligjshme dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të personave fizikë dhe juridikë.

KRU "Prishtina" për gjendjen e rezervave të ujit: Badoci dhe Batllava janë nën nivelin maksimal

PRISHTINË, 31 KORRIK - Gjendja e rezervave të ujit në akumulimet kryesore vazhdon të jetë nën monitorim, ndërsa KRU "Prishtina" ka bërë të ditur se sasia aktuale e ujit garanton furnizim deri në fund të vitit 2026, nëse ai përdoret në

mënyrë racionale.

Sipas të dhënave të fundit, niveli i ujit në liqenin e Badocit është rreth dy metra nën nivelin maksimal të mbushjes, ndërsa në liqenin e Batllavës është 1.69 metra nën kuotën maksimale. Nga KRU "Prishtina" kanë

theksuar se menaxhimi i rezervave dhe mënyra e përdorimit të ujit gjatë muajve në vijim janë faktorë të rëndësishëm për qëndrueshmërinë e furnizimit. "Uji është një burim i kufizuar dhe përdorimi i panevojshëm i

tij, veçanërisht gjatë periudhave me temperatura të larta dhe konsum të shtuar, ndikon drejtpërdrejt në ruajtjen e rezervave dhe në qëndrueshmërinë e sistemit të furnizimit", është thënë në njoftimin e kompanisë.



RRETH 60 MIJË MIGRANTË MËSYJNË NË ENKLAVËN SPANJOLLE CEUTA, MBI 50 TË VDEKUR. MADRIDI DËRGON USHTRINË



Pas arritjes së rreth 60 mijë migrantëve në Ceuta, Madridi dërgoi ushtarë në atë qytet. Kryeministri Sanches dhe ministri i Brendshëm i Spanjës vizitojë Ceutën.

Pas mbërritjes së një numri të madh migrantësh në enklavën spanjolle të Ceutës në Afrikën e Veriut, kryeministri Pedro Sánchez ishte sot atje së bashku me ministrin e Brendshëm të Spanjës Fernando Grande-Marlaska. Kryeministri i Spanjës Sánchez, tha se shkelja e kufirit është "shkelje e integritetit territorial të Spanjës".

Sánchez fajësoi kontrabandistët e qenieve njerëzore për krizën duke thënë se ata "mashtrojnë kaq shumë të rinj dhe, në fund, çojnë shumë prej tyre drejt vdekjes, qoftë në oqean ose, si në këtë rast, në kufirin e Spanjës në qytetin

autonom të Ceutës."

BE-ja ofron mbështetje

Komisioneri për Migracionin, Magnus Brunner, shprehu "gatishmërinë e BE-së për të mbështetur më fortë Spanjën për ta vënë situatën nën kontroll, ndër të tjera përmes Frontex-it", njoftoi ai mbrëmë në platformën X.

Spanja dërgon ushtarë në Ceuta

Spanja dislokoj në Ceuta tri skuadra me nga 20 ushtarë secila, një njësi zhytësish dhe një anije ushtarake, njoftoi Ministria e Brendshme. Sipas agjencisë së lajmeve Reuters edhe njësitë speciale të policisë do të forcohen me gjithsej 200 efektivë. Qeveria deklaroi

se ushtarët do të mbështesin Gardën Civile (Guardia Civil) për të "ruajtur sigurinë në qytetin e Ceutës".

Sipas të dhënave të autoriteteve gjatë ditëve të fundit në Ceuta kanë mbërritur me not më shumë se 60.000 migrantë. Deri tani njoftohet se më shumë 50 prej tyre humbën jetën në përpjekje për të kaluar me not nga Maroku në Ceuta.

Ceuta, është një qytet spanjoll në bregdetin e Afrikës së Veriut. Ky është territor i Bashkimit Evropian dhe kufizohet me Marokun.

Saka, më shumë se gjysma e 60,000 emigrantëve që kanë hyrë në enklavën spanjolle të Ceutës që nga mëngjesi i së premtes janë kthyer tashmë në Marok, sipas Ministrisë së Brendshme të Spanjës, siç citohet nga mediat lokale.

Situatë kaotike

Kreu i sindikatës së Gardës Civile, Rachid Sbihi, e përshkroi situatën në qytet si kaotike. Sipas tij kufiri praktikisht është shembur. "Nuk është e mundur të jepen shifra të sakta, por kufirin po e kalojnë mijëra migrantë", tha ai.

Achraf Maimouni, nga Shoqata Marokene për të Drejtat e Njeriut, e cilësoi situatën si të jashtëzakonshme, kurse autoritetet marokene ende nuk kanë komentuar për këtë çështje.

Presidenti rajonal i Ceutës, Juan Jesús Vivas, i bëri thirrje qeverisë qendrore në Madrid që, për "arsye të sigurisë kombëtare", të shpallë gjendjen e jashtëzakonshme. Ai kërkoi gjithashtu dërgimin e forcave shtesë policore si dhe vendosjen e trupave të ushtrisë në

kufirin mes Marokut dhe Ceutës. Por Madridi e refuzoi shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme në nivel kombëtar.

Shkak i mundshëm një vendim i Gjykatës së Lartë të Spanjës

Një shpjegim i mundshëm për këtë zhvillim lidhet me një vendim të në fillim të korrikut. Sipas këtij vendimi, personat që kapen në det gjatë përpjekjes për të arritur në Ceuta me not nuk mund të kthehen nga autoritetet menjëherë në Marok.

Sipas gjykatës në raste të tilla duhet të ndiqet një procedurë e rregullt sipas legjislacionit për të huajt. Ministria e Brendshme e Spanjës i akuzon rrjetet e kontrabandistëve të migrantëve se po e shfrytëzojnë këtë vendim.

Kriza e emigrantëve në Ceuta, Italia mbyll kufijtë ajrorë dhe detarë me Spanjën

Italia ka vendosur të mbyllë kufijtë ajrorë dhe detarë me Spanjën, në përgjigje të krizës së emigrantëve që ka shpërthyer në Ceuta dhe shqetësimeve për sigurinë e kufijve të zonës Schengen.

Vendimi është marrë nga Ministria e Brendshme italiane, pas analizës së situatës në Komitetin për Analizën e Emigracionit dhe Sigurisë së Kufijve, mbledhje e drejtuar nga

ministri i Brendshëm, Matteo Piantadosi.

Paralelisht, Piantadosi zhvilloi një bisedë telefonike me homologun e tij francez, Laurent Nuñez, gjatë së cilës u ra dakord për forcimin e kontrolleve në kufirin tokësor mes Italisë dhe Francës, në kuadër të marrëveshjeve ekzistuese të bashkëpunimit mes forcave policore të dy vendeve.

Ministri i Jashtëm italian dhe

njëherazi zëvendëskryeministër, Antonio Tajani, ka mbrojtur vendimin e Italisë për pezullimin e përkohshëm të Schengenit me Spanjën, duke e cilësuar atë një masë të nevojshme për garantimin e sigurisë.

Në një reagim në rrjetin social X, Tajani deklaroi se "pezullimi i përkohshëm i Schengenit me Spanjën është një zgjedhje e domosdoshme për të mbrojtur


sigurinë e qytetarëve tanë dhe për të mbrojtur kufijtë evropianë."

Sipas tij, kriza migratore në Ceuta tregon se mbrojtja e kufijve të jashtëm të Bashkimit Evropian është përgjegjësi e përbashkët e të gjitha vendeve anëtare.

"Duhet të punojmë së bashku për të parandaluar hyrjen e flukseve të pakontrolluara të emigrantëve në territorin e Bashkimit Evropian, me të gjitha rreziqet që



kjo sjell, përfshirë kërcënimin e terrorizmit, i cili duhet të luftohet pa asnjë hezitim", u shpreh Tajani.



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

BALLKANI, MALISHEVA DHE DUKAGJINI MBYLLIN RRUGËTIMIN NË UEFA CONFERENCE LEAGUE



PRISHTINË, 31 KORRIK - Ballkani, Malisheva dhe Dukagjini i kanë dhënë fund paraqitjeve në edicionin e sivjetmë të UEFA Conference League, pasi të tri skuadrat kosovare u eliminuan në raundin e dytë kualifikues. Ballkani ishte pranë kualifikimit ndaj Bohemians, por rrugëtimi i skuadrës nga Suhareka ka përfunduar pas ekzekutimit të penalltive në stadiumin "Fadil Vokrri". Ballkani e fitoi ndeshjen 3:2 pas 120 minutave, duke e barazuar rezultatin e

përgjithshëm në 4:4, pasi ndeshjen e parë në Irlandë e kishte humbur 2:1. Megjithatë, Bohemians u tregua më e saktë nga pika e bardhë, duke fituar 5:4 dhe duke kaluar në raundin e tretë kualifikues. Edhe Malisheva e ka mbyllur aventurën evropiane pas disfatës 4:1 ndaj Hibernianit në Skoci. Skuadra kosovare kishte fituar 2:0 në ndeshjen e parë në Prishtinë, por vendasit e kanë përmbysur rezultatit dhe kaluan tutje me rezultat të përgjithshëm

4:3. Në të njëjtën fazë është eliminua edhe Dukagjini, i cili ka pësuar humbje 5:1 nga Lugano në Kampin Nacional të FFK-së në Hajvali. Pas disfatës minimale 1:0 në ndeshjen e parë në Zvicër, skuadra nga Klina ka synuar përmbysjen, por Lugano doli bindshëm fituese. Dukagjini e ka përfaqësuar Kosovën në garat evropiane si fitues i Kupës së Kosovës, ndërsa kjo ishte pjesëmarrja e dytë e klubit në Evropë.

UEFA DHE 55 FEDERATAT ANËTARE KUNDËRSHTOJNË PROPOZIMIN E FIFA-S PËR PËRFSHIRJEN E INVESTITORËVE PRIVATË NË PRONËSINË E KOMPETICIONEVE

PRISHTINË, 31 KORRIK - UEFA dhe 55 federatat e saj anëtare, përfshirë Federatën e Futbollit të Kosovës (FFK) kanë publikuar një deklaratë të përbashkët, në të cilën kanë shprehur kundërshtimin e tyre të plotë ndaj propozimit të FIFA-s për transferimin e interesave të pronësisë mbi Kupën e Botës dhe kompeticionet e tjera të FIFA-s te investitorët privatë.

Në deklaratë, UEFA ka theksuar se Kupa e Botës përfaqëson një nga trashëgimitë më të rëndësishme të futbollit botëror dhe se e ardhmja e saj nuk duhet të vihet në shërbim të interesave financiare. "UEFA dhe 55 federatat e saj anëtare qëndrojnë të bashkuara. Ne e refuzojmë njëzëri dhe pa asnjë ekuivok propozimin e FIFA-s për të transferuar interesa pronësie mbi Kupën e Botës dhe kompeticionet e tjera të FIFA-s te investitorët privatë", është thënë në deklaratë.

Sipas UEFA-s, Kupa e Botës nuk mund të trajtohet si një produkt investimi, pasi ajo përfaqëson një trashëgimi të ndërtuar ndër breza nga futbollistët, ekipet kombëtare dhe tifozët në mbarë botën. "Kupa e Botës nuk mund të trajtohet si një produkt investimi. Ajo është një nga trashëgimitë më të mëdha sportive të futbollit. Është ndërtuar ndër breza nga futbollistët, ekipet kombëtare dhe tifozët në çdo kontinent. Asnjë pjesë e saj nuk duhet t'u

dorëzohet investitorëve privatë. Kupa e Botës nuk është në shitje", është theksuar në deklaratë.

UEFA ka kritikuar edhe mënyrën se si është zhvilluar procesi, duke e cilësuar si të munguar transparencën dhe konsultimin me federatat kombëtare. "Është e papërgjegjshme dhe e pajustificueshme që një propozim me një rëndësi kaq të madhe për futbollin të jetë hartuar në fshehtësi dhe të jetë sjellë pranë miratimit pa asnjë konsultim domethënës me ata që kanë përgjegjësinë për të administruar dhe zhvilluar lojën", është thënë në deklaratë.

Sipas UEFA-s, kjo përbën "një dështim të thellë të liderimit" dhe një shmangie të FIFA-s nga përgjegjësia e saj si kujdestare e futbollit botëror.

Federatat evropiane kanë kundërshtuar edhe atë që e konsiderojnë si presion ndaj federatave kombëtare për të mbështetur propozimin. "Federatat kombëtare në mbarë botën po përballen tashmë me një ultimatum: ose të pranojnë kalimin e pakthyeshem të kompeticioneve më të rëndësishme të futbollit nën kontrollin e interesave private, ose të përballen me pasojat. Ky nuk është një 'vendim demokratik', por një model qeverisjeje përmes intimidimit – një akt presioni që nuk i shkon për shtat një institucioni të ngarkuar me

përgjegjësinë për administrimin e futbollit botëror", është theksuar më tej në deklaratën e UEFA-s.

UEFA ka bërë me dije se kundërshtimi ndaj propozimit të FIFA-s nuk lidhet vetëm me mënyrën se si është zhvilluar procesi, por edhe me pasojat që mund të ketë për të ardhmen e futbollit botëror. "Në momentin që investitorët e jashtëm fitojnë interesa pronësie në kompeticionet e FIFA-s, futbollit ndryshon përgjithmonë. Kthimi financiar i investimit bëhet një detyrim i përhershëm. Pritshmëritë e investitorëve shndërrohen në një presion të përditshëm", është thënë në deklaratë.

Sipas UEFA-s, një model i tillë mund të ndikojë në vendimmarrjen për kalendarin ndërkombëtar, formatin e kompeticioneve dhe drejtimin e ardhshëm të futbollit. "Që nga ai moment, çdo vendim për kalendarin ndërkombëtar, çdo vendim për formatin e kompeticioneve dhe çdo vendim që përcakton të ardhmen e futbollit nuk do të udhëhiqet më nga ajo që i shërben më mirë lojës, por nga ajo që i shërben më mirë aksionarëve", është theksuar në deklaratë.

UEFA ka paralajmëruar se interesat e federatave kombëtare, ligave, klubeve, futbollistëve dhe tifozëve nuk duhet të vendosen në plan të dytë përballë interesave financiare të investitorëve. "Ky



model nuk ka vend në futbollin botëror. E ardhmja e futbollit nuk mund të diktohet nga pritshmëritë e atyre, detyra kryesore e të cilëve është të maksimizojnë fitimin financiar. Futbollit nuk mund ta hipotekojë të ardhmen e tij për përfitime ekonomike", është thënë në deklaratë.

Qëndrimi i UEFA-s, sipas deklaratës, është i prerë dhe nuk do të ketë kompromis për këtë çështje. "Ne nuk do t'i japim kurrë legjitimitetin tonë këtij modeli. Askush nuk ka autoritetin moral të shesë diçka që vetëm e mban në besim për brezin e ardhshëm", është theksuar në deklaratë.

Në fund, UEFA dhe federatat e saj anëtare kanë paralajmëruar se përfaqësueset kombëtare

evropiane nuk do të marrin pjesë në kompeticionet e FIFA-s për sa kohë që propozimet për pronësinë private mbeten në fuqi. "Si rezultat i diskutimeve të sotme, asnjë përfaqësuese kombëtare e federatave anëtare të UEFA-s nuk do të marrë pjesë në asnjë kompeticion të FIFA-s për sa kohë që këto propozime mbeten në fuqi, përveç rastit kur ky propozim të jetë tërhequr plotësisht dhe të jenë dhënë garanci detyruese se FIFA nuk do ta hapë më kurrë qeverisjen apo kompeticionet e saj ndaj pronësisë private. Askush nuk duhet të ketë asnjë dyshim: UEFA dhe federatat e saj kombëtare do t'i kundërshtojnë këto plane me vendosmëri absolute", është thënë në deklaratën e UEFA-s.



Adr: Rr. "Zija Shemsiu", nr.22, Ulpianë – Prishtinë
Tel: +383 (0) 38 606 670; +383 (0) 38 606 672; 0800 11 672
e-mail: mirembajtja@npbanesore.com; info@npbanesore.com

Në bazë të dispozitave të Nenit 8 të Ligjit të Punës, Rregullores për Procedurat e Punësimit dhe Menaxhimit të Marrëdhënies së Punës në NPB – SH.A. Prishtinë, Nr. Protokoli: 01-143/2, datë 10 Shkurt 2026 dhe Rregullores për Sistematizimin e Vendeve të Punës Nr. Protokoli: 01-336/2, datë 11 Mars 2025, Ndërmarrja Publike Banesore Sh.A në Prishtinë, shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendit të punës

Titulli i vendit të punës: Zyrtar/e i/e Lartë për Marrëdhënie në Punë 1 (një) pozitë.

I raporton: Udhëheqësit/es të/së Divizionit të Burimeve Njerëzore

Niveli i pagës:: 5.1

Orët e Punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e Kontratës: Me kohë të pacaktuar (puna provuese 6 muaj)

Vendi Punës: Rr. "Zija Shemsiu" nr. 22, Ulpianë- Prishtinë (selia e Ndërmarrjes Publike Banesore)

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Në bashkëpunim me udhëheqësit e njësive organizative të NPB-së përgatit konkurset për vende të lira pune;
 - Përgatit aktet individuale juridike me të cilat rregullohet statusi juridik i stafit (themelimi dhe ndërprerja e marrëdhënies së punës) me të cilat sigurohet implementimi efikas i administrimit të Divizionit të Burimeve Njerëzore;
 - Kryen punë të tjera administrative që kanë të bëjnë me personelin;
 - Ofron shërbimet e sekretarisë së komisionit disiplinor dhe komisionit për shqyrtimin e ankesave të NPB- së;
 - Drafton, rishikon dokumentet dhe aktet e burimeve njerëzore duke përfshirë propozimin e politikave dhe rekomandimeve relevante të Burimeve Njerëzore;
 - Ofron këshilla verbale dhe me shkrim nga lëmia e burimeve njerëzore për udhëheqësin e Burimeve Njerëzore, stafin e departamentit dhe të punësuarve të tjerë;
 - Kryen detyra ligjore nga fusha e burimeve njerëzore, me fokus të veçantë në çështjet ligjore që kanë të bëjnë me kriteret e përgjithshme të punësimit;
- Zbaton politikat dhe rregullat eaktuara të Burimeve Njerëzore dhe ofron opinionet juridike të mbështetura ne Ligjin e Punës dhe Udhëzimet Administrative;
 - Shqyrtton kërkesat e paraqitura, identifikon rastet e tilla dhe jep rekomandime profesionale për veprime të mëtejme;
 - Ruan informacionin në përputhje me aktet nënligjore të NPB-së dhe Agjencisë për Informim dhe Privatësi;
 - Propozon veprime ligjore brenda autorizimeve dhe përgjegjësi të deleguara;
 - Kryen detyra të tjera që lidhen me pozitën të cilat i ngarkohen nga Udhëheqësi Burimeve Njerëzore.

Kualifikimet:

- Diplomë universitare;
- Së paku 2 vite përvojë pune, preferohet në fusha të ngjashme.

Aftësitë:

- Vëmendje në detaje, ne formulime të qarta dhe saktësi;
- Aftësi të mira komunikuese në të folur dhe të shkruar si dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve sipas prioriteteve;
- Aftësi të shkëlqyeshme për të ofruar konsultim dhe aftësi të mira ndër personale;
- Të jetë në gjendje të punoj nën presion dhe të ketë integritet;
- Njohje e ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës me theks të veçantë në njohjen e Ligjit të Punës dhe Udhëzimet që rrjedhin nga ky Ligj;
- Rrjedhshmëri në të folur dhe në të shkruar të gjuhës shqipe;
- Preferohet njohja e gjuhës angleze;
- Shkathhtësi kompjuterike në Microsoft Office ;
- Preferohet kurse dhe trajnime tjera gjatë karrierës profesionale;
- Preferohet të ketë njohuri në përdorimin e sistemeve informative;
- Shkathhtësi ndër njerëzore që reflektojnë objektivitet dhe diskrecion.

Aplikimi për këtë konkurs mund të bëhet në mënyrë elektronike, duke dërguar dokumentacionin e kërkuar në adresën zyrtare: burimet.njerezore@npbanesore.com. Të gjitha dokumentet duhet të jenë të bashkëngjitura në formatin PDF.

Kandidatët që aplikojnë janë të obliguar të shënojnë saktë adresën e banimit, numrin e telefonit kontaktues si dhe adresën elektronike (e-mail).

Vetëm kandidatët që plotësojnë kriteret e përcaktuara në konkurs do të ftohen në fazat e mëtejshme të procedurës së rekrutimit.

Dokumentet që duhet të bashkangjiten:

- Aplikacioni i NPB-së;
- Dëshmia për Diplomë Universitare;

- Dëshmia mbi përvojën e punës së paku 2 vite, preferohet në fusha të ngjashme.
- Kurse dhe trajnime tjera gjatë karrierës profesionale - preferohet;
- Jetë Përshkrimi (CV);
- Certifikatën e gjendjes penale të lëshuar nga Gjykata, e cila dëshmon që nuk jeni i/e dënuar apo nën hetime (duhet të jetë jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Çertifikatën mjekësore që është në gjendje të mirë shëndetësore si fizike ashtu dhe psiqike para nënshkrimit të kontratës (vetëm kandidati/ja i/e përzgjedhur)

Shënim: Aplikacionet që arrijnë pas afatit të përcaktuar në konkurs nuk pranohen.

Aplikimet e dorëzuara pa nënshkrimin e formularit të aplikimit dhe me qoftë vetëm një dokument të munguar do të refuzohen automatikisht.

Ndërmarrja Publike Banesore ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë burrë apo grua dhe nga të gjitha komunitetet në Republikën e Kosovës.

Njoftim PËR PRIVATËSINË DHE PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE

Ndërmarrja Publike Banesore SHA Prishtinë – NPB SHA Prishtinë, me seli në Prishtinë, në cilësinë e kontrolluesit të të dhënave personale, informon kandidatët për punën lidhur me përpunimin e të dhënave personale gjatë procesit të rekrutimit.

1. Qëllimi i përpunimit:

Të dhënat personale përpunohen me qëllim të:

- Zhvillimit të procedurës së rekrutimit dhe përzgjedhjes;
- Verifikimit të kualifikimeve profesionale;
- Ushtrimit të së drejtës së ankesës;
- Themelimit të marrëdhënies së punës për kandidatët e përzgjedhur.

2. Llojet e të dhënave që përpunohen:

- Të dhënat identifikuese (emër, mbiemër, datëlindje, numri personal);
- Të dhënat e kontaktit;
- Të dhënat mbi arsimin dhe përvojën profesionale;
- Dokumentet mbështetëse të aplikimit;
- Të dhëna të tjera të kërkuara sipas konkursit.

3. Baza ligjore:

Përpunimi i të dhënave personale bëhet në përputhje të plotë me:

- Ligjin Nr. 06–L/062, datë 30 Janar 2019, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale¹;
- Ligjin Nr. 03/L–212, datë 01 Nëntor 2010, I Punës².
- Ligjin Nr. 03/L–087, datë 13 Qershor 2008, Për Ndërmarrjet Publike³, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L–111, datë 20 Prill 2012⁴ dhe Ligjin Nr. 05/L–009, datë 07 Prill 2015⁵;
- Rregulloren Për Mbrojtjen e të Dhënave⁶ në NPB SHA Prishtinë, si dhe aktet nënligjore të brendshme.

4. Afati i ruajtjes:

- Të dhënat personale të kandidatëve që me vullnetin e tyre nuk i nënshtrohen procedurës së rekrutimit pjesërisht apo në tërësi, ruhen deri në tridhjetë (30) ditë, nga përfundimi i procedurës së rekrutimit.
- Të dhënat personale të kandidatëve të papërzgjedhur ruhen deri në një (1) vit nga përfundimi i procedurës së rekrutimit.
- Të dhënat e kandidatëve të përzgjedhur ruhen në dosjen personale gjatë marrëdhënies së punës dhe më pas sipas legjislacionit arkivor.

5. Qasja dhe siguria.Të dhënat personale përpunohen vetëm nga persona të autorizuar dhe m brohen me masa teknike e organizative të përshtatshme.

6. Të drejtat e kandidatëve: Kandidatët kanë të drejtë:Të informohen për përpunimin e të dhënave të tyre;Të kërkojnë qasje në të dhënat e tyre, korrigjim ose fshirje të tyre sipas ligjit;Të paraqesin ankesë pranë Agjencisë për Informim dhe Privatësi.

7. Kontakti:

Për pyetje lidhur me përpunimin e të dhënave personale, kandidatët mund të kontaktojnë:

NPB SHA Prishtinë – Divizioni i Burimeve Njerëzore.

📍 **Lagje "ULPIANA", Rr. "Zija SHEMSIU", Nr. 22, 10000, Prishtinë.**

✉️ burimet.njerezore@npbanesore.com

Shpallja është e hapur që nga data 31.07.2026 deri më 14.08.2026 në ora 23:59.

Për informata më të hollëshme mund të kontaktoni në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Ndërmarrjes Publike Banesore në nr. tel.: 038 553 311.



Adr: Rr. "Zija Shemsiu", nr.22, Ulpianë - Prishtinë
Tel: +383 (0) 38 606 670; +383 (0) 38 606 672; 0800 11 672
e-mail: mirembajtja@npbanesore.com; info@npbanesore.com

Na osnovu odredaba člana 8. Zakona o radu, Pravilnika o postupku zapošljavanja i upravljanja radnim odnosom u JKP – A.D. Priština, br. Protokola: 01-143/2 od 10. februara 2026. godine, kao i Pravilnika o sistematizaciji radnih mesta, br. Protokola: 01-336/2 od 11. marta 2025. godine, Javno stambeno preduzeće A.D. u Prištini objavljuje:

KONKURS
Za popunu radnog mesta

Naziv radnog mesta: Viši službenik za radne odnose – 1 (jedno) izvršilačko mesto
Odgovara: Rukovodiocu Divizije za ljudske resurse

Platni nivo: 5.1

Radno vreme: 40 časova nedeljno

Trajanje ugovora: Na neodređeno vreme (probni rad u trajanju od 6 meseci)

Mesto rada: Ul. „Zija Šemsu“ br. 22, Ulpijana, Priština (sedište Javnog stambenog preduzeća)

Dužnosti i odgovornosti:

- a) U saradnji sa rukovodiocima organizacionih jedinica JSP-a priprema konkurse za slobodna radna mesta;
- b) Priprema pojedinačne pravne akte kojima se uređuje pravni status zaposlenih (zasnivanje i prestanak radnog odnosa), čime se obezbeđuje efikasno sprovođenje administriranja u okviru Divizije za ljudske resurse;
- c) Obavlja druge administrativne poslove koji se odnose na osoblje;
- d) Pruža sekretarske usluge Disciplinskoj komisiji i Komisiji za razmatranje žalbi JSP-a;
- e) Izrađuje i revidira dokumenta i akte iz oblasti ljudskih resursa, uključujući predloge politika i relevantnih preporuka iz oblasti ljudskih resursa;
- f) Pruža usmene i pisane stručne savete iz oblasti ljudskih resursa rukovodiocu ljudskih resursa, osoblju odeljenja i drugim zaposlenima;
- g) Obavlja pravne poslove iz oblasti ljudskih resursa, sa posebnim fokusom na pravna pitanja koja se odnose na opšte kriterijume zapošljavanja;
- h) Sprovodi utvrđene politike i pravila iz oblasti ljudskih resursa i daje pravna mišljenja zasnovana na Zakonu o radu i administrativnim uputstvima;
- i) Razmatra podnete zahteve, identifikuje odgovarajuće slučajeve i daje stručne preporuke za dalje postupanje;
- j) Čuva informacije u skladu sa podzakonskim aktima JSP-a i Agencije za informacije i privatnost;
- k) Predlaže pravne radnje u okviru poverenih ovlašćenja i odgovornosti;
- l) Obavlja i druge poslove koji proizlaze iz radnog mesta, po nalogu rukovodioca ljudskih resursa.

Kvalifikacije:

Univerzitetska diploma;

Najmanje 2 godine radnog iskustva, poželjno u srodnim oblastima.

Veštine:

Pažnja prema detaljima, jasno i precizno izražavanje;

Dobre komunikacione veštine u usmenom i pisanom izražavanju, kao i sposobnost rešavanja problema prema prioritetima;

Izražene konsultantske sposobnosti i dobre međuljudske veštine;

Sposobnost rada pod pritiskom i visok nivo integriteta;

Poznavanje važećih zakona u Republici Kosovo, sa posebnim naglaskom na Zakon o radu i administrativna uputstva koja proizlaze iz njega;

Aktivno znanje albanskog jezika u govoru i pisanju;

Poželjno poznavanje engleskog jezika;

Poznavanje rada u programu Microsoft Office;

Poželjno je posedovanje dodatnih kurseva i obuka tokom profesionalne karijere;

Poželjno poznavanje rada sa informacionim sistemima;

Razvijene međuljudske veštine koje odražavaju objektivnost i diskreciju.

Način prijavljivanja

Prijava na ovaj konkurs može se izvršiti elektronskim putem, dostavljanjem tražene dokumentacije na zvaničnu adresu elektronske pošte: burimet.njerezore@npbanesore.com. Sva dokumenta moraju biti priložena u PDF formatu.

Kandidati koji se prijavljuju dužni su da tačno navedu adresu stanovanja, kontakt telefon, kao i adresu elektronske pošte (e-mail).

Samo kandidati koji ispunjavaju uslove utvrđene konkursom biće pozvani u naredne faze postupka zapošljavanja.

Dokumentacija koju je potrebno priložiti:

Prijavni obrazac JSP-a;

Dokaz o završenom univerzitetskom obrazovanju;

Dokaz o najmanje dve godine radnog iskustva, poželjno u srodnim oblastima;

Dokazi o pohađanim kursovima i drugim obukama tokom profesionalne karijere (poželjno);

Biografija (CV);

Uverenje o nekažnjavanju izdato od nadležnog suda, kojim se potvrđuje da kandidat nije osuđivan niti se protiv njega vodi istraga (ne starije od šest meseci);

Kopija lične karte;

Lekarsko uverenje o dobrom fizičkom i psihičkom zdravstvenom stanju pre potpisivanja ugovora (dostavlja samo izabrani kandidat).

Napomena:

Prijave koje stignu nakon isteka roka utvrđenog konkursom neće biti razmatrane.
Prijave dostavljene bez potpisanog prijavnog obrasca ili sa nedostajućim makar jednim traženim dokumentom biće automatski odbijene.

Javno stambeno preduzeće pruža jednake mogućnosti zapošljavanja svim državljanima Republike Kosovo i ohrabruje prijavljivanje svih lica, bez obzira na pol, kao i pripadnika svih zajednica u Republici Kosovo.

OBAVEŠTENJE O PRIVATNOSTI I OBRADI LIČNIH PODATAKA

Javno stambeno preduzeće A.D. Priština – JSP A.D. Priština, sa sedištem u Prištini, u svojstvu rukovaooca obrade ličnih podataka, obaveštava kandidate za zaposlenje o obradi njihovih ličnih podataka tokom postupka regrutacije.

1. Svrha obrade

Lični podaci obrađuju se u svrhu:

- sprovođenja postupka regrutacije i izbora kandidata;
- provere stručnih kvalifikacija;
- ostvarivanja prava na žalbu;
- zasnivanja radnog odnosa sa izabranim kandidatima.

2. Vrste podataka koji se obrađuju

- Identifikacioni podaci (ime, prezime, datum rođenja, lični broj);
- Kontakt podaci;
- Podaci o obrazovanju i profesionalnom iskustvu;
- Dokumentacija priložena uz prijavu;
- Ostali podaci koji se zahtevaju konkursom.

3. Pravni osnov

Obrada ličnih podataka vrši se u potpunosti u skladu sa:

- Zakonom br. 06/L-082 od 30. januara 2019. godine o zaštiti ličnih podataka;
- Zakonom br. 03/L-212 od 1. novembra 2010. godine o radu;
- Zakonom br. 03/L-087 od 13. juna 2008. godine o javnim preduzećima, izmenjenim i dopunjenim Zakonom br. 04/L-111 od 20. aprila 2012. godine i Zakonom br. 05/L-009 od 7. aprila 2015. godine;
- Pravilnikom o zaštiti podataka u JSP A.D. Priština, kao i internim podzakonskim aktima.

4. Rok čuvanja podataka

- Lični podaci kandidata koji svojom voljom ne učestvuju u postupku regrutacije delimično ili u celosti čuvaju se do trideset (30) dana od završetka postupka regrutacije.
- Lični podaci kandidata koji nisu izabrani čuvaju se do jedne (1) godine od završetka postupka regrutacije.
- Lični podaci izabranih kandidata čuvaju se u njihovom personalnom dosijeu tokom trajanja radnog odnosa, a nakon toga u skladu sa propisima o arhivskoj građi.

5. Pristup i bezbednost

Lične podatke obrađuju isključivo ovlašćena lica i oni su zaštićeni odgovarajućim tehničkim i organizacionim merama.

6. Prava kandidata

Kandidati imaju pravo da:

- budu informisani o obradi svojih ličnih podataka;
- zahtevaju pristup svojim podacima, njihovu ispravku ili brisanje u skladu sa zakonom;
- podnesu pritužbu Agenciji za informacije i privatnost.

7. Kontakt

Za sva pitanja u vezi sa obradom ličnih podataka kandidati se mogu obratiti:

JSP A.D. Priština – Divizija za ljudske resurse
Naselje „ULPIJANA“, ul. „Zija ŠEMSIU“ br. 22, 10000 Priština
E-mail: burimet.njerezore@npbanesore.com
Konkurs je otvoren od 31.07.2026. godine do 14.08.2026. godine do 23:59 časova.
Za dodatne informacije možete se obratiti Diviziji za ljudske resurse Javnog stambenog preduzeća na broj telefona: 038 553 311.



ZIRAAT BANK KOSOVA SH.A

Bilanci i gjendjes me : 30.06.2026	Euro'000	Euro'000
	Tremujori paraprak	Tremujori vijues
Pasurite		
Paraja e gatshme dhe gjendja me BQK-në	38,720	18,448
Kërkesat ndaj bankave	936	6,561
Plasmanet ne Institucionet kreditore	9,003	8,005
Kreditë dhe paradhëniet ndaj klientëve	98,866	103,222
Investimet në letra me vlerë	6,284	6,329
Patundshmëritë dhe pajisjet	1,885	5,633
Pasuritë e paprekshme	344	323
Pasuritë tatimore të shytyra	356	356
Pasuritë tjera	580	655
Gjithsej pasuritë	156,974	149,532
Detyrimet		
Detyrimet ndaj bankave	6,030	7,037
Depozitat e klientëve	128,252	115,827
Fondet tjera të huazuara	-	-
Detyrimet tatimore të shytyra	-	-
Detyrimet tjera	1,161	4,726
Gjithsej detyrimet	135,443	127,590
Ekuiteti i aksionarëve		
Kapitali aksionar	25,000	25,000
Rezervat e kapitalit	-	-
Fitimi i mbajtur	3,579	3,579
Fitimi (humbja) i vitit aktual	110	521
Përbërësit tjerë të ekuitetit	-	-
Gjithsej ekuiteti i aksionarëve	21,531	21,942
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet	156,974	149,532



ZIRAAT BANK KOSOVA SH.A

Pasqyra e të ardhurave me: 30.06.2026	Euro'000	Euro'000
	Tremujori paraprak	Tremujori vijues
Të hyrat nga interesi	1,842	3,745
Shpenzimet e interesit	-	889
Neto të hyrat nga interesi	953	1,905
Të hyrat nga tarifat dhe komisionet	140	306
Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve	-	155
Neto të hyrat nga tarifat dhe komisionet	14	88
Neto të hyrat tjera	12	77
Neto të hyrat (shpenzimet) tjera operative	-	991
Gjithsej të hyrat	40	201
Provizionet për humbjet nga kreditë	161	688
Provizionet tjera	-	11
Fitimi(humbja) para tatimit	110	521
Shpenzimet e tatimit në fitim	-	-
Shpenzimet e tatimit të shytyr	-	-
Fitimi(humbja) neto	110	521
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse	110	521

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, “Floriani Company 2002 ” shpk., Vushtrri, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor për thërrmimin e rërës-zhavorrit dhe riciklimin e mbeturinave inerte ne Gojbulë, Vushtrri.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 18.09.2026 në ora 10:00 ne SHF “Mustafë Venhari”, Vushtrri, do të organizohet debat publik nga “Floriani Company 2002 ” shpk., Vushtrri, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us04web.zoom.us/j/5289487423?pwd=atEPUrNDxCwMcX5GSCHJS7NmAu7JDN.1>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Floriani Company 2002 ” shpk., Vushtrri -për thërrmimin e rërës-zhavorrit dhe riciklimin e mbeturinave inerte ne Gojbulë, Vushtrri,

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, “Peja Industrial Park ” sh.p.k Llabjan, Pejë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor për kompaninë “Peja Industrial Park ” sh.p.k Llabjan, Pejë, për parkun fotovoltaiik për instalimin e gjeneratorit solar me fuqi 4MW –prodhim i energjisë elektrike nga energjia solare me paisje fotovoltaike, ne zonën Kadastrale – Llabjan, njësia kadastrale parcelë: P-71611051-00299-0,.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 21.09.2026 në ora 11:00 ne Kosova Innovation Hub, Çamila Sijarića, Vitomiricë, Pejë 30000, do të organizohet debat publik nga “Peja Industrial Park ” sh.p.k Llabjan, Pejë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us04web.zoom.us/j/9535257790?pwd=dAFk8wygrcGJk62TC60ZQRNygoJzhk>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Pëlqim Mjedisor për për parkun fotovoltaiik për instalimin e gjeneratorit solar me fuqi 4MW –prodhim i energjisë elektrike nga energjia solare me paisje fotovoltaike, ne zonën Kadastrale – Llabjan, njësia kadastrale parcelë: P-71611051-00299-0,.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, “Eco Recycling” Sh.p.k Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor për kompaninë “Eco Recycling” Sh.p.k Prishtinë, për qendrën e grumbullimit, selektimit të mbeturinave të plastikes, letrës, qelqit, aluminit si dhe riciklimin e plastikes dhe prodhimi i produkteve të plastikës në Millosheve, Obiliq.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 21.09.2026 në ora 14:30 ne Shkollen Fillore te Mesme e Ulët “Hasan Prishtina” Milloshevë, Komuna Obiliq, do të organizohet debat publik nga “Eco Recycling” Sh.p.k Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=IsyiMPR68piZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së “për kompaninë “Eco Recycling” Sh.p.k Prishtinë, për qendrën e grumbullimit, selektimit të mbeturinave të plastikes, letrës, qelqit, aluminit si dhe riciklimin e plastikes dhe prodhimi i produkteve të plastikës në Millosheve, Obiliq.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, “TOBACCO GROUP” sh.p.k, Obiliq, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor për kompaninë “TOBACCO GROUP” sh.p.k, Obiliq, për Pëlqim Mjedisor për objekt afarist-depo për përpunimin e produkteve te duhanit, ne ngastren kadastrale P-72614055-00493-1, ZK Obiliq, Komuna Obiliq.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 18.09.2026 në ora 13:30 ne Shkolla Fillore e Mesme Ulet “Pandeli Sotiri” Obiliq, do të organizohet debat publik nga “TOBACCO GROUP” sh.p.k, Obiliq, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=IsyiMPR68piZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Pëlqim Mjedisor për objekt afarist-depo për përpunimin e produkteve te duhanit, ne ngastren kadastrale P-72614055-00493-1, ZK Obiliq, Komuna Obiliq.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Suphi Metëhiu B.I. N.T.P “Ecotech” Vushtrri, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor për kompaninë Suphi Metëhiu B.I. N.T.P “Ecotech” Vushtrri, për Pëlqim Mjedisor për fabrikën e prodhimit te ngjyrave me baze uji dhe produkte solvente në Gllavatin, Vushtrri.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 21.09.2026 në ora 10:00 ne Objektin e Komunës së Vushtrrisë, adresa Sheshi “Ahmet Krasniqi” nr.10, do të organizohet debat publik nga Suphi Metëhiu B.I. N.T.P “Ecotech” Vushtrri, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=IsyiMPR68piZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Pëlqim Mjedisor për fabrikën e prodhimit te ngjyrave me baze uji dhe produkte solvente në Gllavatin, Vushtrri.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, “RONALD” shpk, Baks, Skenderaj, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për , për Pëlqim Mjedisor për Pëlqim Mjedisor për shfrytëzimin e shkëmbit gëlqeror ne Z.K Beqiq, Komuna Vushtrri.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 17.09.2026 në ora 10:00 në objektin e Komunës së Vushtrrisë, do të organizohet debat publik nga “RONALD” shpk, Baks, Skenderaj, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

https://eu-central-1.protection.sophos.com?d=zoom.us&u=aHR0cHM6Ly91czA0d2ViLn timer 20udXMvai80NTQ5MzQ0NDk1P3B3ZD1HYktjb2NjU1d4MzlGM2U4UUy3UHNBa0NM2I2SzYuMQ==&i=NjY1ZjljOWVlZmMxZjE3Nzc3ZWVlZmMxNjRi&t=b3FBYUcxaFc0MVViMG1ya2xodgzgK3RmWThwWUZOVFNLUmlWNnE1NEF5Yz0=&h=c68fed1fcbe14a0db0c82bb7663e3871&s=AVNPUEhUT0NFTkNSWVBUSVaTRAueU-vNbNdW92a0FAisFOgf0Rln55_29at16bUHiQ

Meeting ID: 454 934 4495
Passcode: Aela2019.

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për “RONALD” shpk, Baks, Skenderaj për Pëlqim Mjedisor , për Pëlqim Mjedisor për Pëlqim Mjedisor për shfrytëzimin e shkëmbit gëlqeror ne Z.K Beqiq, Komuna Vushtrri

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

\Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, "RONALD" shpk, Baks, Skenderaj, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për , për Pëlqim Mjedisor për Pëlqim Mjedisor për ndërtimin e Vendosijen e Seperacionit për seperimin e shkëmbit gelqëror, ne Z.K Beqiq, Komuna Vushtrri.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 17.09.2026 në ora 11:00 në objektin e Komunës së Vushtrrisë, do të organizohet debat publik nga "RONALD" shpk, Baks, Skenderaj, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

https://eu-central-1.protection.sophos.com?d=zoom.us&u=aHR0cHM6Ly91czA0d2Vilnpvb20udXMvai80NTQ5MzQ0NDk1P3B3ZD1HYktjb2NjU1d4MzIGM2U4UUy3UHNBa0NNM2J2S2YyUHQ=&i=NjY1ZjJjOWVlZmMxZjE3Nzc3ZWxMxNjRi&t=b3FBYUcxaFc0MVVIMG1ya2xodgzK3RmWThwWUZOVFNlUmlWNnE1NEF5Yz0=&h=7a605e76847348c2b29c38032dcac6ba&s=AVNPUeHUTONFTKNSWVBUSVaTRAueU-vNbNdW92a0FAisFOgfORln55_29at16bUHiQ

Meeting ID: 454 934 4495

Passcode: Aela2019.

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për "RONALD" shpk, Baks, Skenderaj për Pëlqim Mjedisor , për ndërtimin e Vendosijen e Seperacionit për seperimin e shkëmbit gelqëror, ne Z.K Beqiq, Komuna Vushtrri.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, "Floriani Company 2002 " shpk., Vushtrri, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor për thërrmimin e rërës-zhavorrit dhe riciklimin e mbeturinave inerte ne Gojbulë, Vushtrri.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 18.09.2026 në ora 10:00 ne SHF "Mustafë Venhari", Vushtrri, do të organizohet debat publik nga "Floriani Company 2002 " shpk., Vushtrri, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us04web.zoom.us/j/5289487423?pwd=atEPUrNDxCwMcX5GSCHJ57NmAu7JDN.1>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Floriani Company 2002 " shpk., Vushtrri -për thërrmimin e rërës-zhavorrit dhe riciklimin e mbeturinave inerte ne Gojbulë, Vushtrri,

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpeite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Qamil Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Gjergj Kastrioti" në Mazdrek.

- Valmir Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Gjergj Kastrioti" në Mazdrek.

- Elton Halili shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së 11 të shkollës së mesme të lartë të mjekësisë "Dr. Xheladin Deda".

- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.

- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m."Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Maurita Koca nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjmnazit "Hajdar Duishi" Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Lëshohet banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshohet banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshohet banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

- Lëshohet banesë me qira, pent-house. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

